

GJYKATA E APELIT
Numri i lëndës: PAKR 413/2013
(P 346/2012 Gj/Th Pejë)

Më 6 qershor 2014

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Manuel Soares, kryetar dhe gjyqtar raportues, gjyqtarit të EULEX-it Tore Thomassen dhe gjyqtares Tonka Berishaj, anëtarë të kolegjit, me asistimin e zyrtares ligjore të EULEX-it Anna Malmström, e cila vepron si procesmbajtëse.

TË PANDEHURIT

N.M, i lindur më XX 19XX në fshatin _____, _____, emri i të atit N, emri i nënës F (I), banues në rrugën _____ ;
R.Z, i lindur më XX 19XX në _____, emri i të atit Q, emri i nënës I (R), banues në rrugën _____ ;
X.Z, i lindur më XX 19XX në _____, emri i të atit Q, emri i nënës I (R), banues në rrugën _____ ;
M.N, e lindur më XX 19XX në _____, _____, emri i të atit L, emri i nënës L (L), banuese në _____ .

AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË APELIT

Sipas nenit 407 dhe atyre në vazhdimësi të KPP-së¹, në lidhje me ankesat e parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Pejës i shpallur më 23 maj 2013, në lëndën me numër 346/2013, kolegji i Gjykatës së Apelit e vendos këtë:

1. Refuzohet aktakuza *ex officio* me të cilën i pandehuri **N.M** akuzohet për veprën penale nga neni 374 (1) i KPRK-së për shkak të përjashtimit nga ndjekja penale sipas neneve 2.1 dhe 3.1.1.10 të Ligjit mbi Amnistinë;

2. Pjesërisht pranohen ankesat e parashtruara nga mbrojtësi Bajram Tmava në emër të të pandehurit **N.M**, nga mbrojtësja Rezarta Metaj në emër të të pandehurit **N.M**, nga i pandehuri **N.M**, nga mbrojtësi Zekir Berdyna në emër të të pandehurit **R.Z**, nga i pandehuri **R.Z**, nga mbrojtësi Kastriot Spahiu në emër të të pandehurit **X.Z**, nga i pandehuri **X.Z** dhe nga mbrojtësi Haxhi Millaku në emër të të pandehurës **M.N** dhe rrjedhimisht aktgjykimi ndryshohet me sa vijon:

a) I pandehuri **N.M** dënohet me tre (3) vjet burgim për veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 (1) të KPRK-së (i aplikueshëm sipas nenit 3 (2) të KPRK-së si ligj më i favorshëm) dhe tetë (8) muaj burgim për veprën penale të Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit sipas nenit 339 (1) të KPK-së. I pandehuri është dënuar me dënim unik prej tre (3) vjet e gjashtë (6) muaj burgim. Njëherazi i pandehuri u dënuar me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në periudhë kohore prej tre (3) vjetësh pas përfundimit të afatit të burgimit;

¹ Shkurtesat në vijim që u referohen kodeve përkatëse do të përdorën tash e tutje në tekst: Kodi penal paraprak: KPK, Kodi penal në fuqi: KPRK, Kodi i procedurës penale paraprak: KPP, Kodi i procedurës penale në fuqi: KPPK.

b) I pandehuri **R.Z** u dënua me një (1) vit burgim për veprën penale të Ushtrimit të ndikimit, sipas nenit 345 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe me tre (3) vjet burgim për veprën penale të Shtytjes në keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 (1) lidhur me nenet 31 dhe 32 të KPRK-së (i aplikueshëm sipas nenit 3 (2) të KPRK-së si ligj më i favorshëm). I pandehuri u dënua me dënim unik prej tre (3) vjetësh e gjashtë (6) muaj burgim;

c) I pandehuri **X.Z** u dënua me një (1) vit burgim për veprën penale të Ushtrimit të ndikimit, sipas nenit 345 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së dhe me tre (3) vjet burgim për veprën penale të Shtytjes në keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 (1) lidhur me nenet 31 dhe 32 të KPRK-së (i aplikueshëm sipas nenit 3 (2) të KPRK-së si ligj më i favorshëm). I pandehuri u dënua me dënim unik prej tre (3) vjetësh e gjashtë (6) muaj burgim;

d) Hiqet masa e konfiskimit të sendeve nga 1 deri në 14 dhe 24 gjatë bastisjes së shtëpisë të të pandehurve **R.Z** dhe **X.Z**;

e) E pandehura **M.N** u dënua me gjashtë (6) muaj burgim për veprën penale të Ndhmës në shpërdorimin e pozitës zyrtare ose të autorizimit, sipas nenit 339 (1) lidhur me nenin 25 të KPK-së, me kusht për periudhë verifikimi prej dy (2) vjetësh;

3. Sipas nenit 102 të KPP-së të pandehurit urdhërohen të paguajnë brenda 15 ditësh shumën prej 250 eurosh secili individualisht në mbështetje të shpenzimeve të procedurës, pa paragjykuar mundësinë e gjykatës së shkallës së parë për të marrë një aktvendim të ndarë mbi këtë çështje.

4. Për të gjitha aspektet e tjera të papërmendura, ankesat refuzohen dhe aktgjykimi vërtetohet.

ARSYETIMI

1. Përmbledhje e procedurës relevante

Procedura në shkallën e parë

Më 31 korrik 2012, prokurori i EULEX-it ngriti aktakuzën PP nr. 114/12 në Gjykatën e Qarkut të Pejës ndaj të pandehurve **N.M**, **R.Z**, **X.Z** dhe **M.N** duke i akuzuar ata për këto vepra penale:

- Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit sipas nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së (ndaj **N.M**);

- Shpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autorizimit sipas nenit 339 (1) të KPK-së (ndaj **N.M**);

- Posedim i paautorizuar i armëve sipas nenit 328 (2) të KPK-së (ndaj **N.M**);

- Ushtrim i ndikimit sipas nenit 345 (1) të KPK-së lidhur me nenin 23 të KPK-së (ndaj **R.Z** dhe **X.Z**);

- Shtytja në shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit sipas nenit 339 (1) dhe (3) të KPK-së lidhur me nenet 23 dhe 24 të KPK-së (ndaj **R.Z** dhe **X.Z**);

- Ndhmë në shpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit sipas nenit 339 paragrafi 1 të KPK-së lidhur me nenin 25 të KPK-së (ndaj **M.N**).

Aktakuza u konfirmua me aktvendimin KA. Nr. 228/12 më 17 shtator 2012.

Më 4 dhjetor 2012 aktakuza ishte ndryshuar. Vepra penale e Marrjes së dokumenteve zyrtare dhe ajo e Mashtrimit të blerësve, për të cilat janë akuzuar të pandehurit **R.Z** dhe **X.Z**, janë ndarë nga kjo lëndë penale.

Shqyrtimi gjyqësor filloi më 3 dhjetor 2012 para kolegjit të ish Gjykatës së Qarkut të Pejës. Më tej u mbajtën 19 seanca të gjykimit para se të shpallej aktgjykimi P 346/12 më 23 maj 2013, me të cilin të gjithë të pandehurit u shpallen fajtor për veprat penale për të cilat akuzoheshin.

Më 5 gusht 2013 ankesa kanë ushtruar të pandehurit **N.M**, **R.Z** dhe **X.Z** dhe mbrojtësi Bajram Tmava në emër të të pandehurit **N.M**. Më 6 gusht 2013 ankesë ka ushtruar mbrojtësi Zeqir Berdyna në emër të të pandehurit **R.Z**, më 7 gusht 2013 avokatja Rezarta Metaj në emër të të pandehurit **N.M** dhe mbrojtësi Kastriot Spahiu në emër të të pandehurit **X.Z**. Së fundi, më 10 gusht 2013 ankesë ka ushtruar mbrojtësi Haxhi Millaku në emër të të pandehurës **M.N**. Prokurori i EULEX-it ka parashtuar përgjigje në ankesa më 22 gusht 2013.

Procedura në Gjykatën e Apelit

Mendimi i prokurorit të apelit është paraqitur në Gjykatën e Apelit më 26 gusht 2013.

Seanca publike është mbajtur më 7 maj 2014.

Kolegji i Gjykatës së Apelit u këshillua dhe votoi më 7 maj 2014.

Aktgjykimi është përfunduar më 6 qershor 2014.

2. Aktgjykimi i kundërshtuar

Gjykata e shkallës së parë gjeti se faktet në vijim janë provuar (përmbledhja e përshtimit):

- Në mes të qershorit 2010 dhe 27 prillit 2011, i pandehuri **N.M**, duke vepruar në cilësinë e prokurorit në hetimet penale kundër **P.M**, me dashje për të përfituar shumë prej 50.000 eurosh për vete dhe për bashkë të pandehurit **R.Z** dhe **X.Z**, ka ofruar pushimin e hetimeve, ka siguruar ndërprerjen e arrestit shtëpiak dhe këtyre bashkë të pandehurve u ka zbuluar informacione të besueshme të cilat u kanë mundësuar atyre që të zhvatin nga **P.M** shumë prej 30.250 euro. Ai njëkohësisht e ka lejuar **P.M** të dilte nga banesa e tij në kundërshtim me kufizimet e shqiptuara me masën e arrestit shtëpiak.
- Të pandehurit **R.Z** dhe **X.Z**, duke vepruar në bashkëkryerje, me dashje kanë nxitur bashkë të pandehurin **N.M** që të vepronte ashtu sikurse u përshkrua dhe zhatën nga **P.M** shumë e përmendur prej 30.250 eurosh.
- Para datës 11 shtator 2011, i pandehuri **N.M**, duke vepruar si prokuror në dy hetime penale, me qëllim që të siguronte përfitim material për vete, i zbuloi bashkë të pandehurës **M.N** informacione zyrtare, me synimin që ajo të kontaktonte të dyshuarit për këto hetime duke u ofruar atyre ndërprerjen e hetimeve në këmbim të pagesës së një shume të papërcaktuar parash gjë të cilën ajo e bëri sipas udhëzimeve.
- E pandehura **M.N** me dashje i ka asistuar bashkë të pandehurit **N.M** për të vepruar sikurse u përshkrua më sipër.

Të pandehurit u dënuan me sa vijon:

- **N.M**, me 4 vjet burgim për veprën penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 (1) të KPRK-së (i aplikueshëm sipas nenit 3 (2) të KPRK-së si ligj më i favorshëm), 1 vit burgim dhe 10.000 euro gjobë për veprën penale të Shpërdorimit

të pozitës zyrtare ose të autorizimit sipas nenit 339 (1) të KPK-së, 3 muaj burgim për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim, apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, sipas nenit 374 (1) të KPRK-së ((i aplikueshëm sipas nenit 3 (2) të KPRK-së si ligj më i favorshëm), me 5 vjet burgim dhe gjobë 10.000 euro si dënim unik dhe me dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në periudhë kohore prej 3 vjetësh pas përfundimit të afatit të burgimit; ndaj tij u caktua edhe konfiskimi i revoles, karikatorit dhe fishekëve të sekuestruar;

- **R.Z** u dënua me 1 vit e 6 muaj burgim dhe gjobë prej 10.000 eurosh për veprën penale të Ushtrimit të ndikimit, sipas nenit 345 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së, me 3 vjet burgim për veprën penale të Shtytjes në keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 (1) lidhur me nenet 31 dhe 32 të KPRK-së (i aplikueshëm sipas nenit 3 (2) të KPRK-së si ligj më i favorshëm) dhe me dënim unik prej 4 vjetësh burgim e gjobë prej 10.000 eurosh; ndaj të pandehurit u shqiptua edhe masa e konfiskimit të sendeve 1 deri në 14 dhe 24 të sekuestruara gjatë bastisjes së shtëpisë së të pandehurit;
- **X.Z**, u dënua me 1 vit e 6 muaj burgim dhe gjobë prej 10.000 eurosh për veprën penale të Ushtrimit të ndikimit, sipas nenit 345 (1) lidhur me nenin 23 të KPK-së, me 3 vjet burgim për veprën penale të Shtytjes në keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 422 (1) lidhur me nenet 31 dhe 32 të KPRK-së (i aplikueshëm sipas nenit 3 (2) të KPRK-së si ligj më i favorshëm) dhe me dënim unik prej 4 vjetësh burgim e gjobë prej 10.000 eurosh; ndaj të pandehurit u shqiptua edhe masa e konfiskimit të sendeve 1 deri në 14 dhe 24 të sekuestruara gjatë bastisjes së shtëpisë së të pandehurit;
- **M.N**, u dënua me gjashtë (6) muaj burgim dhe gjobë prej 10.000 eurosh për veprën penale të Ndhmës në shpërdorimin e pozitës zyrtare ose të autorizimit, sipas nenit 339 (1) lidhur me nenin 25 të KPK-së.

3. Pranueshmëria e ankesave

Aktgjykimi i shkallës së parë është një vendim i cili është kundërshtuar me ankesë. Palët në kohë kanë shprehur dëshirën për të ushtruar ankesë. Ankesat janë parashtruar brenda periudhës kohore të paraparë me ligj nga të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre, të cilët bëjnë pjesë tek personat që kanë të drejtë ligjore për ta bërë këtë. Megjithatë për shkak të faktit se të dy mbrojtësit e të pandehurit **N.M** ushtruan ankesa në mënyrë kumulative, atëherë çështja e pranueshmërisë së tyre duhet të adresohet.

Gjykata e shkallës së parë, duke mos vepruar sipas nenit 407 (2) të KPP-së, pranoi të dyja ankesat e ushtruara nga dy mbrojtësit e të pandehurit **N.M**. Gjykata e Apelit është në dijeni të kësaj praktike të pranimit të ankesave të ushtruara nga më shumë se një mbrojtës për të njëjtin të pandehur, bazuar në interpretimin e drejtpërdrejtë të nenit 71 (1) të KPP-së: “*I pandehuri mund të ketë deri në tre mbrojtës*” dhe të nenit 399 (1) të KPP-së: “*Ankesë mund të ushtrohet nga (...)* mbrojtësi (...).” Megjithatë pranimi i ankesave të ndryshme dhe në mënyrë potenciale, kontradiktore, nga përfaqësuesit e të njëjtës palë nuk është diçka që kërkohet lidhur me parimin e ‘gjykimit të drejtë’. Për më tepër, neni 71 (2) i KPP-së thotë: “*e drejta për mbrojtje [kur i pandehuri ka më shumë se një mbrojtës] konsiderohet se është mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit*”. Bazuar në këtë dispozitë, gjykata e shkallës së parë ka mundur ta hedh poshtë njëri nga ankesat, pasi që e drejta për ta kundërshtuar aktgjykimin – d.m.th. e

“drejta në mbrojtje” në atë fazë të caktuar – ka skaduar atëherë kur njëri nga mbrojtësit ka përmbushur veprimin procedural.

Gjykata e Apelit megjithatë konsideron se është jo e duhur hedhja poshtë e ankesës në këtë fazë. Rregullat e procedurës dhe të drejtat e mbrojtjes gjithsesi duhet të jenë njësoj të balancuara dhe parimi i stabilitetit dhe besimit në procedurë doemos duhet të sigurohen. Për shkak se gjykata e shkallës së parë i ka pranuar ankesat, do të ishte jo adekuate për të vendosur ndryshe duke i ballafaquar ankuesit me hedhjen poshtë të pa pritshme.

Gjykata e Apelit i pranon të gjitha ankesat si të pranueshme.

4. Meritat e ankesave

Ankesat në përgjithësi nuk janë tërësisht të qarta dhe në shumë aspekte relevante madje as të arsyetuara mjaftueshëm. Gjatë seancës së kolegjit, palët janë paralajmëruar për këto mangësi dhe atyre iu dha mundësia për të sjellë sqarime plotësuese për pohimet për të cilat kolegji nuk ishte i kënaqur. Në disa aspekte, megjithatë, pohimet e ankuesve mbetën të turbullta dhe të pakuptueshme. Gjithsesi duhet të theksohet se për ta kundërshtuar një aktgjykim mbi çështjet për të cilat nuk mundë të shqyrtohen *ex officio* nuk është e mjaftueshme për të pohuar në mënyrë përfundimtare se aktgjykimi i shkallës së parë është i gabuar. Është më se e domosdoshme për të pohuar pse është i gabuar dhe për të qenë i saktë sa më shumë që të jetë e mundur për cilësimin e bazave ligjore për ta kundërshtuar atë. Ky është një obligim i palëve që del nga detyra për ta sjellë “arsyetimin e ankesës” (neni 401 (1) 3) i KPP-së). Nuk pritet që gjykata e cila e shqyrton aktgjykimin, të ‘gërmoj’ në formulimin e parashtrësive duke u orvatur të ia ‘qëlloj’ dëshirës së palëve.

Në vazhdim, Gjykata e Apelit do t’i shtjelloj një nga një të gjitha çështjet e kundërshtuara nga ankuesit. Për ta bërë këtë në mënyrën më logjike dhe më të kuptueshme të mundur, çështjet e ngritura në të gjitha ankesat do të vendosen sipas rendit të përcaktuar me ligj.

4.1. Shkeljet substanciale të dispozitave të procedurës penale

Përbërja jo e duhur e gjykatës: neni 403 (1) 1) i KPP-së

Mbrojtësi Haxhi Millaku (për të pandehurën M.N) ka pohuar se procedurat është dashur të zhvillohen në formë të përmbledhjes së neneve 461 deri në 465 të KPP-së sepse krimi që i ngarkohet të pandehurës ishte i dënueshëm me burgim deri në 1 vit. Prokurori ka parashtruar përgjigje duke pohuar se procedura e shkurtër nuk është e aplikueshme në një hetim të përbashkët sa i përket dhënies së ndihmës në kryerjen e një krimi të dënueshëm me burgim të barabartë apo më të lartë se 3 vjet në pajtueshmëri me nenin 33 (4) të KPP-së. Prokurori i apelit ka shtuar se për shkak se e pandehura është bashkëkryerëse, ajo është dashur të kalojë nëpër të njëjtën ecure të bashku me të pandehurit e tjerë.

Çështja ishte ngritur nga mbrojtësi në seancën mbi konfirmimin e aktakuzës në të njëjtën mënyrë sikurse në ankesë. Gjyqtari i procedurës paraprake e ka trajtuar çështjen me aktvendim për konfirmim të aktakuzës dhe refuzoi kundërshtimin duke iu referuar nenit 33 (4) të KPP-së. Çështja u ngrit përsëri nga mbrojtësi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 14 shkurt 2013 por ajo e cila

rrjedhimisht bëhet e ditur në procesverbal, kolegji nuk e ka adresuar më pastaj dhe nuk e ka adresuar as në aktgjykim.

Sipas këndvështrimit të Gjykatës së Apelit, vendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake për të refuzuar këtë kundërshtim nuk mund të ankimohet. Neni 33 (4) dhe (5) i KPP-së është i qartë kur thotë se si parim, gjykata e cila ka kompetencë për kryerësit e veprës penale, duhet të ketë kompetencë edhe për bashkëkryerësit në procedurën e bashkuar. Koncepti i referuar i “bashkëkryerësve” ndërlidhet me të gjitha format e bashkëpunimit në veprat penale, të përcaktuara me nenet 23 deri në 26 të KPK-së, përfshirë edhe “ndihmën”. Pra, pasi që me aktakuzë e pandehura **M.N** u akuzua për veprën penale të ndihmës në kryerjen e veprës penale të Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar që i ngarkohet bashkë të pandehurit **N.M**, konfirmimi i aktakuzës për të dy veprat penale është ekuivalent me vendimin e bashkimit të procedurës sipas propozimit të prokurorit. Dhe për këtë arsye, neni 33 (8) i KPP-së, nuk lejon ankesë ndaj atij vendimi. Kolegji i shkallës së parë nuk ka pasur ta adresojë përsëri këtë kundërshtim sepse kjo është vendosur paraprakisht nga gjyqtari i procedurës paraprake me një vendim të plotfuqishëm.

Pjesëmarrja e një gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet (neni 403 (1) 2) i KPP-së)

Çështja e përjashtimit të gjyqtarëve ishte ngritur në ankesat e të pandehurve **N.M**, **R.Z** dhe **X.Z** dhe të mbrojtësve Bajram Tmava (**N.M**), Rezarta Metaj (**N.M**) dhe Kastriot Spahiu (**X.Z**). Ata të gjithë kanë pohuar se të tre gjyqtarët është dashur të përjashtohen sipas nenit 40 (2) të KPP-së. Prokurori ka dhënë përgjigje duke pohuar se vendimet mbi paraburgimin në të cilat gjyqtarët kanë qenë paraprakisht të përfshirë nuk i takojnë konceptit ligjor të “procedurës paraprake” të nenit 40. Prokurori i apelit ishte pajtuar dhe ka shtuar se Gjykata Supreme e ka vendosur këtë çështje në një lëndë identike duke konsideruar se kjo nuk shpie në përjashtim (aktgjykimi PKL-kzz 71/09 i datës 10 nëntor 2009).

Sipas të dhënave, gjyqtari Malcolm Simmons ishte kryetar i kolegjit që ka vendosur mbi vazhdimin e paraburgimit në KP Nr. 57/12 të datës 2/5/12, anëtari i kolegjit, gjyqtari Dariusz Sielicki ishte kryetar kolegji në KP Nr. 50/12 të datës 24/4/12 dhe anëtarja e kolegjit, gjyqtarja Elmaze Syka ishte anëtare e kolegjit që ka vendosur për ankesën ndaj paraburgimit në KA Nr. 228/12, PPS Nr. 114/12. Është korrekte që të tre gjyqtarët kanë trajtuar çështjen e paraburgimit në kolegjin e përbërë prej tre gjyqtarësh sikurse pohohet nga mbrojtja. Gjyqtari Malcom Simmons madje ka qenë edhe në kolegjin që ka vazhduar vet paraburgimin, duke mos vendosur për ankesën. Gjyqtari Dariusz Sielicki ka qenë në kolegjin që është marrë me ankesën e prokurorit për analizën e ekspertit dhe gjyqtarja Elmaze Syka ka qenë në kolegjin që ka hedhur poshtë ankesën e prokurorit si të papranueshme – kërkesa e prokurorit ishte për të urdhëruar që të pandehurve të mos u lejohej të kishin vizitor në të ardhmen.

Kur ka filluar shqyrtimi gjyqësor, kryetari i kolegjit e solli këtë çështje në vëmendjen e palëve. Nuk ka pasur kundërshtime për përbërjen e kolegjit nga askush. Më 18 mars 2013 i pandehuri **R.Z** vet solli një numër çështjesh të përjashtimit kundër anëtarëve ndërkombëtarë të kolegjit dhe prokurorit. Por fakti se ata kanë vendosur në lëndë më parë nuk ishte një nga arsyet. Çështjet e ngritura janë trajtuar në seancën e radhës me aktvendime verbale.

Neni 416 i KPP-së thotë se kjo shkelje e pohuar mund të referohet në ankesë vetëm nëse ankuesi *“nuk ka mundur të paralajmërojë shkeljen gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, ose nëse paralajmërimi i tij nuk është përfillur nga gjykata e shkallës së parë”*. Siç u theksua më sipër, të gjithë ankuesit kanë pasur mundësin të ngritin këtë çështje gjatë shqyrtimit gjyqësor por nuk e bënë. Gjykata *ex officio* madje i ka pyetur nëse kishin ndonjë kundërshtim në këtë aspekt dhe ata nuk patën. Ata, tani, për këtë arsye nuk mund t’i referohen një shkeljeje të supozuar të procedurës me të cilën ata u pajtuan paraprakisht. Por edhe sikur të kishin, ankuesit nuk kanë të drejtë sepse shkelja e theksuar e procedurës thjesht nuk ka ndodhur.

Gjykata Supreme (GjS) në dy lëndë për mbrojtje të ligjshmërisë, në njërën duke vepruar si gjykatë e shkallës së dytë dhe në tjetrën si shkallë e tretë, ka vendosur mbi çështjet relevante për të. E para është Ap-Kz nr 371/2008, e datës 10 prill 2009, dhe është shumë e ngjashme me këtë. I pandehuri ka pohuar se dy gjyqtarët ishin përjashtuar nga kolegji i shkallës së parë sepse ishin ata, respektivisht kryetari i kolegjit dhe një anëtar i kolegjit të përbërë prej tre gjyqtarësh që gjatë fazës së procedurës paraprake kanë vendosur mbi vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit. Njëri nga gjyqtarët e miratoi edhe kërkesën e prokurorit publik për vazhdimin e periudhës për parashtrim të aktakuzës. Gj/S duke zbatuar nenin 40 të KPP-së, konsideroi se gjyqtarët nuk e kishin ushtruar funksionin e gjyqtarit hetues (duke iu referuar ligjit të ish Jugosllavisë) dhe se *“veprimtaria e tyre nuk mund të konsiderohet si “pjesëmarrje në procedurë paraprake” sepse kjo nuk përmban ushtrimin e funksioneve të caktuar të gjyqtarit të procedurës paraprake. Vendimi i kolegjit prej tre gjyqtarësh mbi vazhdimin (ose ndërprerjen) e paraburgimit ka qenë i përcaktuar sipas kodit paraprak dhe është ende i përcaktuar me KPPK-në si veprimtari e veçantë mbi çështjet e sigurisë e cila nuk është pjesë e fazës së caktuar të procedurës.”* Lënda e dytë është Pkl-Kzz 71/09, e datës 10 nëntor 2009. Në këtë lëndë gjyqtari ka qenë pjesë e kolegjit prej tre gjyqtarësh për të vendosur mbi paraburgimin. Më pastaj ai ka qenë pjesë e kolegjit të apelit të Gj/S duke vepruar si shkallë e dytë. Gj/S i ka shtjelluar arsyet e përmendura për përjashtimin e nenit 40 dhe ndërlidhjen e tyre me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Njëra prej arsyeve të jurisprudencës së GjEDNj-së, Gj/S e ka vlerësuar përjashtimin e gjyqtarit edhe sipas aspekteve subjektive edhe sipas atyre objektive dhe përsëri konsideroi se gjyqtari duke vepruar në kolegjin prej tre gjyqtarësh *“nuk ka ushtruar funksionet e gjyqtarit të procedurës paraprake, të kërkuara me nenin 40 par 2 nën-para 1 të KPPK-së”*. Po ashtu edhe kualiteti substancial i vendimit të hasur në procedurën paraprake *“nuk ka ofruar argumente të mjaftueshme për përjashtimin e gjyqtarit në fazë të mëvonshme të procedurës. Kolegj në fjalë e ka marrë lëndën për çështje sigurie, pra i ka vlerësuar kushtet për paraburgim.”* *“Gjyqtari në fjalë nuk i ka trajtuar aspak meritat e lëndës por ka vlerësuar vetëm kushtet për paraburgim.”*

Ky trup gjykues në këtë lëndë iu referua edhe një lëndë të GjEDNj-së *“Hauschildt vs Danimark”*, të cilës Gjykata Supreme iu ka referuar në lëndën e përmendur më sipër. Në te, GjEDNj-ja nxori konkluzionin se në sistemin e tillë si ai danez (i cili është pakëz më ndryshe sepse hetimet zhvillohen dhe udhëhiqen nga policia dhe prokurori e jo nga gjyqtari) nuk mund të bëhet fakti se një gjyqtar që ka marrë pjesë në një vendim të procedurës paraprake mbi paraburgimin ta arsyetoj në vete frikën e paanshmërisë.

Çështja e ngritur nga ankuesit ndërlidhet me nenin 40 (2) 1) të KPP-së sepse të gjithë gjyqtarët të cilët kanë qenë anëtarë të trupit gjykues morën pjesë në procedurën paraprake. Sikurse ishte

theksuar edhe nga Gjykata Supreme dhe nga GJEDNJ-ja, përjashtimi i një gjyqtari nga shqyrtimi gjyqësor ka për qëllim të sigurojë paanshmërinë e gjykatës dhe për ta parandaluar atë duke e vendosur paraprakisht çështjen lidhur me të njëjtin të akuzuar, ai ose ajo mund të veprojë njëanshëm për shkak të paragjyqimit rreth fajësisë së të akuzuarit. Kjo do të ndodhë në rastet ku intervenimi i mëhershëm i gjyqtarit ishte i tillë që ai ose ajo ka mundur të formojë një opinion mbi meritat e lëndës. Vendimet të cilat ndërlidhen me paraburgimin, me pranimin e provave dhe me lejimin e vizitorëve tek të burgosurit, sikurse këto të marra nga gjyqtarët e trupit gjyqësor, nuk ndërlidhen drejtpërsëdrejti me meritat e lëndës së shqyrtimit gjyqësor. Në vendosje të asaj nëse ekziston dyshimi i fuqishëm për një krim dhe nëse janë plotësuar kushtet paraprake të paraburgimit ose në vendosje mbi një ekspertizë ose nëse një i burgosur mund të ketë vizita, janë çështje të ndryshme nga vendosja nëse faktet janë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe nëse ato përbëjnë një krim.

Pra Gjykata e Apelit nxjerr konkluzionin se nuk ka pasur shkelje të procedurës lidhur me pjesëmarrjen në gjykim të gjyqtarit i cili duhej të ishte përjashtuar.

Mungesa e kundërligjshme e personave, prania e të cilëve në shqyrtimin gjyqësor kërkohet me ligj (neni 403 (1) 3) i KPP-së)

I pandehuri **X.Z** ka pohuar se shqyrtimi gjyqësor ishte zhvilluar në mungesë të personave prania e të cilëve kërkohet me ligj në shkelje të të drejtave të mbrojtjes. Asnjë detaje apo deklaram tjetër nuk është paraqitur.

Kjo nuk është një çështje të cilën Gjykata e Apelit mund ta adresojë *ex officio* sipas nenit 415 (1) të KPP-së. Prandaj me qëllim të kundërshtimit të një shkeljeje të tillë procedurale, ankuesi është i obliguar të jap një “arsyetim të ankesës” (sikurse përmendet me nenin 401 (1) të KPP-së). Kjo nënkupton që treguesi i saktë se kush duhet të jetë i pranishëm dhe nuk e bëri këtë dhe kur ka mundur të ndodhë kjo, duhet të thuhet nga ankuesi. Ankuesit i është dhënë rasti ta qartësojë këtë çështje (sikurse u shënuar në procesverbalin e seancës së kolegjit) por ai nuk arriti ta bëjë këtë. Gjykata e Apelit konsideron se në këtë aspekt, ankesa nuk është arsyetuar mjaftueshëm për tu shqyrtuar.

Mohimi i përdorimit të gjuhës amtare (neni 403 (1) 3) të KPP-së)

I pandehuri **N.M** pohoi se kur ka dhënë deklaratën e tij më 19 prill 2012, atij i është mohuar përdorimi i gjuhës së vet amtare boshnjake, dhe se i është dashur ta nënshkruaj procesverbalin pa e lexuar dhe pa e kuptuar.

Sipas të dhënave, kur i pandehuri ka dhënë deklaratën e tij në rastin e përmendur ai nuk e ka ngritur çështjen e nevojës apo kërkesës për një përkthyes të gjuhës boshnjake. Pasi ka dhënë deklaratën e vet, ai ka qenë i njoftuar për të drejtën e tij për ta lexuar procesverbalin dhe për të iu përkthyer në gjuhën shqipe por vullnetarisht ka hequr dorë nga e drejta e tij për ta lexuar. Ai e ka nënshkruar atë në fund dhe i ka vënë inicialet e tij në fund të secilës faqe. Nuk ka asgjë që është vërejtur në procesverbal lidhur me kundërshtimin e tij për ta nënshkruar, sikurse përcaktohet me nenin 89 (7) të KPP-së. Është evidente se i pandehuri e flet dhe e kupton shkëlqyeshëm gjuhën shqipe, që është njëra nga gjuhët zyrtare të shtetësisë së tij dhe gjuha të cilën ai e ka përdorur gjatë gjithë pjesës tjetër të procedurës pa të vetmen ankesë. Për më tepër, ai ka qenë prokuror në Kosovë dhe e ka shfrytëzuar këtë gjuhë profesionalisht. Sipas nenit 15 (1) dhe (2) të KPP-së,

gjuha shqipe është njëra nga gjuhët zyrtare të procedurës penale dhe vetëm personit i cili nuk e flet njëren nga to, i pranohet e drejta për të përdorur një gjuhë tjetër. Kjo e drejtë pranohet për të siguruar parimin e një “gjykimi të drejtë”, sepse është e qartë se të kuptuarit e procedurës është njëra nga mjetet esenciale për ta lejuar mbrojtjen. Qëllimi i ligjit nuk është për t’i dhënë të pandehurit mundësinë e zgjedhjes së gjuhës të cilën ai e pëlqen më së tepërmi e madje edhe më pak për t’i lejuar atij të shfrytëzoj pretekste artificiale për të ngritur kundërshtime të pabaza. Madje edhe të drejtat e mbrojtjes duhet të ushtrohen në mënyrë të paanshme dhe besnike e jo abuzive.

Në lidhje me nënshkrimin e procesverbalit, të dhënat nuk e mbështesin pohimin e të pandehurit. Përveç kësaj ai ka qenë i ndihmuar nga një avokat dhe për shkak të profesionit të tij ai është shumë i vetëdijshëm për të drejtat e veta. Ai shumë lehtë ka mundur ta shfrytëzojë të drejtën e miratuar me nenin 89 (1) të KPP-së dhe të kërkoj që procesverbali t’i përkthehet dhe lexohet para sa ta nënshkruaj. Por procesverbali e tregon saktësisht të kundërtën: ai ka qenë i njoftuar për atë të drejtë dhe ka hequr dorë nga ajo. Pohimi se ai ishte nën presion për të nënshkruar procesverbalin është i paqartë, subjektiv dhe nuk mbështetet me asnjë provë të cilat Gjykata e Apelit mund t’i vlerësojë.

Mos gjykimi i plotë i lëndës së akuzës (neni 403 (1) 7) i KPP-së)

Mbrojtësi Haxhi Millaku (për M.N) ka kundërshtuar aktgjykimin mbi këtë bazë duke pohuar se gjykata nuk ka arritur të eliminoj shkeljet fundamentale lidhur me mungesën e bazës ligjore të aktakuzës dhe nuk ka arritur të vërtetoj faktet vendimtare në favor të të pandehurit dhe t’i falë besueshmërinë provave të paraqitura nga i pandehuri. Nuk është thënë se cilat fakte janë paraqitur por nuk janë vërtetuar, cilat kundërshtime apo prova janë paraqitur kundër aktakuzës por nuk janë vlerësuar apo pranuar.

Shkelja substanciale procedurale e paraparë me nenin 403 (1) 7) të KPP-së ndërlidhet me mos gjykimin e plotë të fakteve të propozuar nga prokurori në aktakuzë (vërtetimi i tyre si të provuara apo të paprovuara), në kundërshtim me tejkalimin e gjykimin të aktakuzës (në nën paragrafin 10 të të njëjtit nen). Kundërshtimi i të pandehurit nuk ndërlidhet me faktet e ngarkuara në aktakuzë por në vend të kësaj me mos gjykimin e fakteve apo kundërshtimeve të mbrojtjes, që është një çështje e ndryshme procedurale. Mos gjykimi i plotë i substancës së mbrojtjes si shkelje e procedurës parashihet me nenin 403 (2) 2) të KPP-së. Megjithatë, edhe pse është cilësuar gabimisht, Gjykata e Apelit do ta shtjelloj tani këtë çështje.

Paraqitja e fakteve nga ana e mbrojtjes për tu shtjelluar dhe vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor apo i kundërshtimeve ndaj aktakuzës, është e rregulluar me nenet 308, 309 (4) dhe 311 të KPP-së. Pas marrjes së aktakuzës ose jo më vonë se në seancën për konfirmim, mbrojtja është e obliguar për të propozuar fakte dhe prova të cilat dëshiron t’i diskutojë dhe shqyrtojë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu me një parashtrësë të ndarë me shkrim, mbrojtja mund të paraqes kundërshtime ndaj aktakuzës ose ndaj pranueshmërisë së provave të propozuara nga prokurori. Madje edhe gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor mbrojtja mund të zgjerojë kundërshtimin e vet dhe të propozojë fakte dhe prova të reja ose të paraqes propozime, bazuar në nenin 360 (4) të KPP-së. Të gjitha këto çështje p.sh. faktet, provat dhe propozimet e bëra nga mbrojtja, duhet të vlerësohen dhe vendosen nga gjykata me aktgjykim të formës së prerë, sipas nenit 396 (7) të KPP-së. Mos arritja për t’i vërtetuar faktet si të provuara ose të paprovuara ose për të vendosur

mbi propozimet e paraqitura nga mbrojtja do të jetë shkelje procedurale sipas nenit 403 (2) 1) të KPP-së po që se ky lëshim ka ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë. Gjykata e Apelit vëren se gjykata e shkallës së parë nuk ka dështuar të shohis secilin fakt, të shqyrtojë provat apo të vendos mbi secilin propozim të parashtuara nga ankuesi. Ankuesi e ka kundërshtuar aktakuzën dhe në seancën për konfirmim ka pohuar se nuk ka pasur dyshim të bazuar mirë. Ai ka paraqitur vetëm argumente të përgjithshme dhe përfundimtare duke pohuar se ajo nuk i ka kryer krimet dhe se nuk ka prova që ajo i ka kryer ato. Nuk ka asnjë pohim apo provë konkrete faktike të propozuar në kundërshtim të aktakuzës të cilën gjyqtari nuk ka arritur ta vlerësojë. Edhe në shqyrtimin gjyqësor nuk kishte asnjë provë apo fakt të paraqitur. E pandehura zgjodhi të mos japë asnjë provë dhe mbrojtësi i saj dha një argument shumë të shkurtër përfundimtar. Asnjë parashtresë nuk është paraqitur me shkrim në asnjërin fazë. Për motive të sipër përmendura, Gjykata e Apelit është e mendimit se nuk ka pasur shkelje të cituara procedurale.

Përdorimi i provave të papranueshme (neni 403 (1) 8) i KPP-së

Para se të adresohen provat të cilat ankuesit i konsiderojnë të papranueshme, Gjykata e Apelit e konsideron të dobishme të vë në pah dy aspekte relevante të përgjithshme lidhur me vlefshmërinë e provave. E para është se, sipas nenit 153 (1) të KPP-së, jo të gjitha shkeljet e dispozitave procedurale i bëjnë provat doemos të papranueshme. Ligji është i qartë në pohimin se vetëm kur papranueshmëria e provave shprehimisht parashihet me ligj, gjykata nuk mund ta bazoj një vendim në to. Të gjitha shkeljet e tjera të rregullave procedurale mbi grumbullimin e provave do të përbëjnë vetëm shkelje esenciale nëse ato kanë pasur ndikim në marrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë, sikurse thuhet në nenin 403 (2) të KPP-së. E dyta është se, sipas nenit 154 të KPP-së, pa paragjykuar *ex officio* detyrat e gjykatës, pala ka për obligim të ngrit çështjet të cilat ndërlidhen me pranueshmërinë e provave në kohën kur prova parashtrohet në procedurë, në konfirmimin e aktakuzës, ose përjashtimisht, më vonë, nëse pala nuk ka qenë në dijeni të çështjes ose për shkak të paraqitjes rrethanave të reja të justifikueshme. Nëse pala nuk arrin ta bëjë këtë dhe i pranon provat e parashtuara pa kundërshtim, ajo nuk do të lejohet të kundërshtoj papranueshmërinë e atyre provave me ankesë, vetëm nëse janë paraqitur rrethana të justifikueshme.

Duke pasur në mendje këto parime, Gjykata e Apelit tani do të trajtojë secilën nga pavlefshmëritë e pohuara të provave.

1. Ligjshmëria për t'i atribuar **P.M** statusin e dëshmitarit bashkëpunues dhe për ta pranuar dëshminë e tij si provë të pranueshme ishte kundërshtuar në ankesat e të pandehurve **N.M, R.Z** dhe **X.Z** dhe të mbrojtësve Bajram Tmava (**N.M**), Rezarta Metaj (**N.M**) dhe Kastriot Spahiu (**X.Z**). Në mënyrë esenciale ata të gjithë pohuan se dëshmitar bashkëpunues është ai i cili është i dyshuar ose i pandehur në lidhje me të cilin ende nuk është lexuar aktakuza në shqyrtimin gjyqësor dhe se kur **P.M** i ishte atribuar kjo cilësi ai nuk ndodhej në asnjërin nga këto situata. Prokurori është përgjigjur në mbështetje të ligjshmërisë së statusit të dëshmitarit bashkëpunues sepse **P.M** ishte i dyshuar për veprën penale të dhënies së ryshfetit. Ai ka shtuar se edhe po që se kjo nuk do të ishte çështja, provat do të ishin të pranueshme sepse cilësia e dëshmitarit bashkëpunues është vetëm për t'i siguruar dëshmitarit të drejtat dhe mbrojtjen. Prokurori i apelit ka theksuar atë se dëshmia e **P.M** ishte vërtetuar me dëshmi të tjera.

P.M së pari herë është dëgjuar më 1 shkurt 2012. Nuk ishte e qartë nëse ai ishte dëgjuar si dëshmitar, i pandehur apo i dyshuar. Atij i është dhënë statusi i dëshmitarit bashkëpunues më 22 maj 2012, përderisa gjendja e tij ende nuk ishte definuar.

Neni 298 i KPP-së thotë se statusi i dëshmitarit mund t'i jepet një të dyshuari ose të pandehuri në lidhje me të cilin aktakuza ende nuk është lexuar në shqyrtimin gjyqësor. Ligji parasheh përkufizime të veçanta lidhur me konceptin e të "dyshuarit" në nenin 151 (1) të KPP-së: "*i dyshuari është person për të cilin policia ose autoritetet e ndjekjes penale kanë dyshim të arsyeshëm se ka kryer veprë penale por kundër të cilit procedura penale nuk ka filluar*". Ligji nuk e përcakton nevojën e një procedure formale – aktvendimin, komunikimin ose të tjera – me qëllim për t'i dhënë dikujt cilësinë e të "dyshuarit". Kur **P.M** ishte intervistuar për herë të parë ai tashmë ishte i dyshuar për përfshirje në veprime kriminale nën hetime, pasi që ai mund të akuzohej se e ka paguar prokurorin për t'i pushuar hetimet. Prandaj, sipas këndvështrimit të Gjykatës së Apelit, kushtet e nenit të përmendur 298 janë plotësuar, pavarësisht faktit se asnjë hetim formal nuk kishte filluar kundër dëshmitarit.

Për më tepër, madje edhe po që se statusi i dëshmitarit bashkëpunues gabimisht do t'i ishte atribuuar **P.M**, dëshmia e tij nuk do të mund të kundërshtohet si e papranueshme sepse nuk ka dispozitë në ligj që shprehimisht e përcakton atë pasojë. Statusi i dëshmitarit bashkëpunues kryesisht ka dy objektiva: (1) lehtësojë hetimet kriminale lidhur me faktet të cilat në një tjetër mënyrë do të ishte e vështirë ose e pamundur për t'i provuar dhe (2) dëshmitarit, i cili e vë veten në atë situatë të vështirë, të ia sigurojë të drejtat dhe mbrojtjen. Ky është një opsion që i jepet prokurorit për të krijuar një strategji të përshtatshme për hetime dhe përgjegjësi penale dhe për të zgjedhur të ndalojë zhvillimin e një hetimi kundër dikujt në këmbim të marrjes së dëshmisë bashkëpunues kundër të dyshuarve ose të pandehurve të tjerë. Por pikërisht për shkak se kjo do të thotë se prova është më delikate, në kundërshtim me dëshmitarët e tjerë, ligj nuk e konsideron të mjaftueshme për ta shpallur një person fajtor nëse nuk vërtetohet me prova të tjera, sikurse parashihet me nenin 157 (4) të KPP-së. Kjo nënkupton se dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues nuk e ka një vlerë të privilegjuar dhe prandaj, edhe po që se do të kishte ndonjë cenim të formaliteteve të procedurës, kjo nuk do të kishte ndikim në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë.

2. Mbrojtësja Rezarta Metaj (**N.M**) ka kundërshtuar edhe vlefshmërinë e dëshmisë së dhënë nga **P.M** më 1 shkurt 2012 për shkak të faktit se nuk ishin ndjekur dispozitat ligjore mbi intervistimin e dëshmitarit. Dëshmitarit nuk i janë dhënë udhëzime nga prokurori lidhur me deklarinimin dhe avokati e ka udhëzuar dëshmitarin se si të përgjigjet në pyetje

Mënyra se si është referuar procesverbali është korrekte. **P.M** u dëgjua si dëshmitar nga prokurori më 1 shkurt 2012 dhe asnjë udhëzim nuk i është dhënë. Ai e kishte të pranishëm mbrojtësin me të cilin u konsultua shtatë herë para se të jepte përgjigje pasi që u njoftua paraprakisht se mund ta bënte këtë. E njëjta ka ndodhur gjatë shqyrtimit mbi caktimin e statusit të dëshmitarit bashkëpunues më 22 maj 2012.

Situatat për të cilat deklaratat e dëshmitarëve janë të papranueshme janë ato të përmendura në nenet 156 (2), *a contrario sensu*, dhe 161 të KPP-së. Mungesa e udhëzimeve të qarta të neneve 160 (3), 162 dhe 164 (2) të KPP-së nuk përfshihet si shkak i papranueshmërisë. Pra, sikurse është

theksuar më parë, kjo shkelje e ligjit procedural do të konsiderohet substanciale vetëm nëse ka pasur ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Dëshmia e parë e përmendur e dhënë nga dëshmitari pa udhëzime ligjore nuk dallon në mënyrë substanciale nga ajo e dhënë në shqyrtimin gjyqësor ku dëshmitari ishte udhëzuar në mënyrë të drejtë. Kjo nënkupton se mos dhënia e udhëzimeve nuk ka pasur ndikim në dëshmi. Prandaj sipas pikëpamjes së Gjykatës së Apelit, nuk është shkaktuar asnjë dëm në nxjerrjen e një aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë dhe nuk ka pasur shkelje të ligjit procedural për shkak të gabimit procedural.

Në lidhje me deklaratën e dytë të përmendur në shqyrtimin për përcaktimin e statusit të dëshmitarit bashkëpunues, është e vërtetë se ligji e ndalon që ajo mund të vlerësohet si provë lidhur me veprat penale. Neni 300 (1) i KPP-së thotë se deklaratat e dhëna gjatë këtij shqyrtimi, nuk mund të përdoren si prova që mbështesin zbulimin e fajësisë. Duke e lexuar me kujdes aktgjykimin, Gjykata e Apelit konsideron se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar këtë deklaratë si provë për të mbështetur fajësinë e ndonjërit nga të pandehurit. Deklarata ishte përmendur në Aneks e edhe në faqen 34 të aktgjykimit por vetëm për të justifikuar veprimin procedural për të atribuar statusin e dëshmitarit bashkëpunues, e jo si provë për të zbuluar fajësinë.

Në aspektin tjetër, dëshmitari mund ta ketë asistimin e një avokati në rast se përgjigja që jepet mund ta qoj atë në ndjekje penale sipas nenit 162 të KPP-së. Në kohën kur **P.M** ishte intervistuar si dëshmitar, ai ishte i dyshuar dhe duke dhënë prova ai ka mundur ta vë veten në rrezik. Prania e mbrojtësit gjatë dhënies së deklaratës në atë gjendje, është e drejtë e përgjithshme e dëshmitarit që nuk ndalohet me ligj. Sipas procesverbalit, dëshmitari ishte konsultuar me mbrojtësin shtatë herë para se të jepte përgjigje. Në mënyrë të qartë, përmbajtja e konsultës nuk është – dhe nuk duhet – të shënohet në procesverbal. Por pasi që nuk ka arsye për të supozuar se mbrojtësi ka ndërhyrë në thelbin e dëshmisë, por në vend të kësaj e ka këshilluar dëshmitarin për të drejtat e tij, Gjykata e Apelit nuk mund të nxjerr konkluzionin se ka pasur ndërhyrje në dëm të të pandehurve; për më tepër, për shkak se dëshmia e kontestuar është në mënyrë thelbësore e njëjtë me atë të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor kur ai nuk ka pasur mbrojtës për t'i asistuar.

3. I pandehuri **N.M** ka pohuar se provat e tjera të kundërligjshme ishin vlerësuar në aktgjykim. Gjykata e Apelit tani do të trajtojë të gjithat pavlefshmëritë e kundërshtuara nga ankuesi. Është pohuar se dëshmitari **T.G** nuk ka mundur të japë deklaratë sepse ai kishte vepruar si mbrojtës i dëshmitarit **P.M** në lëndën në të cilin ai ishte hetuar sepse ka pranuar pagesën për të dhënë prova kundër të pandehurit.

Përjashtimi i përfshirë në nenin 160 (1) 5) të KPP-së është krijuar në interes të personave të cilët janë të mbrojtur me fshehtësinë e marrëdhënies profesionale dhe jo në interes të të pandehurit në rast se mbrojtësi mund të jap prova. Mbetet në mbrojtësin për të refuzuar të jap deklaratë mbi çështjet të cilat ai apo ajo i ka mësuar gjatë ushtrimit të profesionit. Ligji nuk e ndalon mbrojtësin të jap prova për një lëndë penale ku i mbrojturi i tij nuk është i pandehur por në vend të kësaj është dëshmitar. Procesverbali nuk tregon asnjë kundërshtim të mbrojtësit apo kërkesë për tu liruar nga detyra e dëshmimit.

Po ashtu absolutisht nuk ka asnjë informacion se mbrojtësi ka pranuar ndonjë pagesë për të dhënë prova. Ky është tërësisht një pohim i pabazuar për të cilin Gjykata e Apelit mund të mos i kushtoj vëmendje.

Ankuesi njëherazi ka pohuar se ai ishte i droguar dhe i paaftë kur i ka dhënë deklaratën e tij prokurorit më 19/4/2012. Kjo sipas tij, do të ishte, rast i provave të ndaluara që do të binte nën dispozitat e nenit 155 të KPP-së.

Përsëri e gjithë kjo është një pohim pa asnjë mbështetje apo madje edhe qëndrueshmëri. Po të ishte e vërtetë se i pandehuri ka dhënë deklaratë të rrejshme gjatë hetimeve për shkak të administrimit të pavullnetshëm të drogës, ai ka pasur mundësinë ta përmirësoj deklaratën e tij në shqyrtimin gjyqësor në vend se të zgjedhtë për të heshtur.

Ankuesi ka pohuar se deklaratat e dëshmitarit **P.M** më 11/3/2011 dhe 1/2/2012 janë dhënë pa praninë e të pandehurit ose mbrojtësit të tij. Pohimi duket të jetë korrekt, pasi më 11/3/2011 në procesverbal nuk është shkruar kush ka qenë i pranishëm gjatë deklaratës së dhënë në polici. Gjithsesi duhet të vihet në pah se thirrja e të pandehurit ose mbrojtësit të tij që të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit në fazën hetimore është aftësi diskrete e prokurorit, sipas nenit 237 (4) të KPP-së. Pra dëshmia mundë të jetë provë e pranueshme vetëm kur të pandehurit i është dhënë mundësia ta kundërshtojë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe nuk bie nën papranueshmërinë e nenit 156 (2) të KPP-së.

Është kundërshtuar edhe vlefshmëria e përgjimeve telefonike sepse ato janë bërë para se të fillojnë hetimet me aktvendim përkatës.

Aktvendimi mbi fillimin e hetimeve është nxjerrë më 10/02/2012. Urdhëresa për të zbuluar përmbajtjen e porosive telefonike ishte nxjerrë më 13/02/2012 për periudhën prej 01/06/2010 deri më 20/04/2011. Në kundërshtim me pohimin e ankuesit, përgjimi ishte urdhëruar dhe zhvilluar pas fillimit të hetimeve, edhe pse u referohet të dhënave të periudhës së mëhershme. Ankuesi duhet të vërej se neni 256 i KPP-së lejon përgjimin e telekomunikimeve përfshirë këtu monitorimin dhe incizimin e drejtpërdrejtë të bisedave dhe qasjen në të dhënat e regjistrimit të thirrjeve të kaluara telefonike. Ligji nuk e përjashton qasjen në të dhënat e porosive tekstuale të kaluara, po që se autorizimi është lëshuar sipas rregullit gjatë fazës hetimore. Gjykata e Apelit nuk konsideron se secila provë e vlerësuar nga gjykata është e papranueshme e as e pavlefshme.

Aktgjykimi ka tejkalluar akuzën (neni 403 (1) 10) i KPP-së)

1. Mbrojtësi Bajram Tmava (**N.M**) ka pohuar se me propozimin e masës plotësuese të ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike që nuk ishte propozuar në aktakuzë, aktgjykimi ka tejkalluar akuzën. Prokurori ka dhënë përgjigje duke pohuar se dënimet plotësuese janë çështje e cilësimit juridik dhe se aktakuza doemos duhet të përfshijë vetëm akuzën faktike dhe jo kërkesën për një dënim të caktuar. Aktakuza e ngritur ndaj të pandehurit nuk i ka propozuar gjykatës të shqiptoj kundër të pandehurit një dënim plotësues. As gjatë shqyrtimit gjyqësor ky propozim nuk ishte përmendur dhe gjykata nuk e ka njoftuar të pandehurin për këtë mundësi. I pandehuri me aktgjykim u dënua me ndalim të ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në periudhë kohore prej tre (3) vjetësh pas përfundimit të afatit të burgimit.

Përveç referimit në nenin 56 (2) të KPK-së, asnjë arsye tjetër specifike nuk ishte dhënë. Çështja e ngritur në ankesë ndërlihet me mbrojtjen e dhënë të drejtës në mbrojtje si një nga aspektet e të drejtës për një gjykim të drejtë.

Neni 305 i KPP-së nuk e parashikon treguesin e dënimeve të mundshme dhe dispozitat përkatëse ligjore si përmbajtje të detyrueshme të aktakuzës. Akuza do të jetë e plotësuar duke iu referuar fakteve, emërtimit ligjor të veprës penale dhe citimin e dispozitave përkatëse ligjore. Përgjigja e prokurorit duke iu referuar nenit 379 të KPP-së nuk është argument relevant ndaj arsyes së ankuesit. Fakti se prokuroria mund të mos propozojë një lartësi të caktuar të dënimit në fjalën përfundimtare nuk do të thotë doemos se ky propozim për dënim plotësues nuk mund të përfshihet në aktakuzë. Dhe për më tepër, madje edhe nëse aktakuza është e heshtur për këtë çështje, gjykata mund ta këshillojë të pandehurin për atë mundësi. Çështje e kontestueshme është, megjithatë, nëse ky informacion kërkohet për të siguruar të drejtën për një mbrojtje efektive si pjesë e të drejtës për një gjykim të drejtë.

E drejta për një gjykim të drejtë si njëra nga të drejtat fundamentale mbrohet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Mbrojtja kushtetuese dhënë kësaj të drejte duhet të interpretohet në të njëjtën masë sikurse me nenin 6 të Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut, që përcaktohet me jurisprudencën e KEDNj (nenet 22 (2) dhe 53 të Kushtetutës). Pra është e rëndësishme të shihet sa larg shkon jurisprudenca e KEDNj në nenin 6.3(a) të konventës, lidhur me të drejtën e të qenit të informuar menjëherë dhe në hollësi për natyrën dhe shkakun e akuzimit.

Në lëndën *Salvador Torres v. Spanjë* ishte pohuar që fakti se i pandehuri kishte qenë i dënuar për një veprë me rrethana rënduese për të cilat ai shprehimisht asnjëherë nuk ishte akuzuar, përbënin shkelje të nenit 6.3(a). Gjyqtari hetues në lëndë konsideroi se faktet e vërtetuara nga ai zbuluan veprën penale të “përvetësimit të fondeve publike”. Gjykata e shkallës së parë konsideroi se paragrafi i përvetësimit të fondeve publike nuk ishte i aplikueshëm sepse ai nuk ishte shërbyes civil sikurse kërkohet dhe se paratë e përvetësuar nuk ishin fonde publike dhe e shpalli atë fajtorë për përvetësim të thjesht duke e dënuar me 18 muaj burgim. Prokuroria parashtrori ankesë por jo edhe i akuzuari. Gjykata Supreme gjithashtu konsideroi se “përvetësimi i fondeve publike” nuk ishte i aplikueshëm. Megjithatë ata e shpallën fajtor për një formë të rëndë të përvetësimit të thjesht sepse ai e ka shfrytëzuar natyrën publike të pozitës së tij në kryerjen e detyrave të cilat i janë besuar dhe e dënuan me pesë vjet burgim. Gjykata gjeti se natyra publike e pozitës së parashtruesit të kërkesës ishte një element thelbësor për akuzën fillestar të përvetësimit të fondeve publike dhe prandaj e njohur për të që nga fillimi i hershëm i procedurës. Prandaj ai gjithsesi duhet të konsiderohet se ishte në dijeni të mundësisë që gjykatat do të konsideronin se ky element themelor faktik, në një kontekst më pak të rëndë të përvetësimit të thjesht, përbën një rrethanë rënduese për qëllim të përcaktimit të dënimit. Nuk është gjetur asnjë cenim i të drejtave të kërkuarit sipas nenit 6.

Në kuadër të këtij vendimi, mund të pohohet se edhe një dënim plotësues është një element thelbësor i dënimit të veprës penale. Nëse i akuzuari është në dijeni të fakteve dhe të veprës penale, ai ose ajo duhet të jetë i vetëdijshëm për ligjin i cili ndërlihet me veprën, përfshirë edhe parimin dhe dënimet plotësuese të aplikueshme.

Në lëndën *T. v. Austri* kërkuesi në një lëndë në vazhdim e sipër ka bërë kërkesë për ndihmë juridike. Ai ka paraqitur deklarin e mjeteve, sipas të cilit nuk ka pasur të ardhura, pronë apo pasuri të tjera. Forma standarde për këtë deklarin ka përmbajtur një paralajmërim se, në rast se ndihma juridike është siguruar në mënyrë të kundërligjshme duke bërë deklaratatë të rreme dhe jo të plota, atëherë mund të shqiptohet një gjobë për keqpërdorim të procesit. Gjykata, pa mbajtur shqyrtim, hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit dhe shqiptoi një gjobë për keqpërdorim të procesit. Gjykata e Apelit konsideroi se parashtruesi e kërkuetit se ai kishte kursime të cilat i kishin lejuar atij të paguante qiranë, përbënte fakte të reja të cilat ishin të papranueshme në procedurën e apelit. Gjykata me të drejtë konsideroi se ai kishte bërë deklarin jo të plotë ose të rrejshëm dhe se gjoba ishte shqiptuar në mënyrë të drejtë. GjEDNj vuri në dukje se parashtruesi i kërkesës mësoi se akuzat ishin drejtuar kundër tij vetëm kur iu dorëzua vendimi i gjykatës. Edhe pse kishte të drejtë në ankesë, ankesa nuk do të mund të rregullonte mangësitë e procedurës së shkallës së parë sepse Gjykata e Apelit e konfirmoi gjykatën e shkallës së parë pa shqyrtim dhe parashtruesat e bëra nga kërkuesi në mbrojtjen e tij ishin të papranueshme për ankesën. Në këtë lëndë, gjykata konsideroi se kishte shkelje të nenit 6.3(a).

Megjithatë ky rast konteston një situatë thelbësisht tjetër sepse ndërlihet me njohjen e mëhershme të gjendjes faktike që gjykata e vlerësoi për ta vendosur dhe jo vetëm për dënimin e pranueshëm. Ky në mënyrë të qartë është rast i modifikimit të fakteve dhe jo i cilësimit juridik. Në lëndën *Dallos v. Hungari*, parashtruesi i kërkesës ishte ndjekur dhe në gjykatën e shkallës së parë ishte dënuar për përvetësim. Gjykata e Apelit e ri-cilësoi veprën penale si mashtrim; ishte një mundësi për të cilën gjykata nuk e vuri atë në dijeni. GjEDNj-ja ri-kujtoi se paanshmëria e procedurës duhet të vlerësohet gjithësi në lidhje me procedurën si tërësi. Dispozitat e nenit 6.3 (a) nxjerrin në shesh nevojën për t'i kushtuar vëmendje të veçantë informimit të të pandehurit për akuzën. Veçantitë e veprës penale luajnë një rol kyç në procesin penal, që është prej momentit të dorëzimit të tyre që i pandehuri është vënë zyrtarisht në njoftimin me shkrim për bazën faktike dhe ligjore të akuzave ndaj tij. Kjo dispozitë e konventës i jep të pandehurit të drejtën për të qenë i informuar jo vetëm për “shkakun” e akuzës, e që janë veprimet të cilat supozohet se i ka kryer dhe në të cilat bazohet akuza, por edhe karakterizimi ligjor që u jepet këtyre akuzave. Ky informacion duhet të jetë i hollësishëm. GjEDNj-ja gjeti se parashtruesi i ankesës vërtet nuk ishte në dijeni se ai mund të ballafaqohet me ri-cilësimin e veprës së tij penale si mashtrim. Kjo rrethanë sigurisht që i uli shanset e tij për tu mbrojtur në lidhje me akuzat për të cilat ai përfundimisht ishte dënuar. Megjithatë në këtë aspekt, GjEDNj-ja i ka atribuar rëndësi vendimtare procedurës në vazhdim në Gjykatën Supreme. Ajo vërejti se Gjykata Supreme tërësisht ka shqyrtuar rastin e parashtruesit të kërkesës, edhe nga këndvështrimi i të drejtës procedurale edhe asaj materiale. Përveç që ka studiuar shkresat e lëndës të gjykatave më të ulëta dhe parashtruesat e kërkuetit dhe të prokurorisë, trupi gjykues dëgjoi në seanca publike adresimet verbale nga mbrojtësit e parashtruesve të kërkesave dhe Zyra e Përgjithshme e Prokurorisë. Për më tepër vet Gjykata Supreme ka mundur ta zëvendësoj dënimin e kërkuetit me vendimin për lirim. Në këtë mënyrë GjEDNj-ja gjeti se kërkuesi e pati mundësinë për ta avancuar mbrojtjen e tij para Gjykatës Supreme në lidhje me akuzën e riformuluar. Duke e vlerësuar drejtësinë e procedurës si tërësi – dhe në pikëpamje të natyrës së shqyrtimit të lëndës para Gjykatës Supreme – GjEDNj-ja ishte e plotësuar se çdo e metë në procedurë në Gjykatën Rajonale ishte përmirësuar në Gjykatën Supreme.

Në lëndën *Sipavičius v. Latvia*, parashtruesi i kërkesës në aktakuzë ishte akuzuar për marrje të pronës me mashtrim dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare. Ai ishte liruar nga këto akuza. Megjithatë Gjykata Rajonale gjeti se ai kishte kryer detyrat e tij si polic në mënyrë jo të duhur për shkak të neglizhencës. Ky dështim përbënte shkelje të një dispozite të caktuar të veprimit policor dhe gjyqtari e shpalli atë fajtor për veprën penale të Neglizhencës zyrtare. Atij nuk iu bë me dije se një mundësi ishte edhe ri- cilësimi. GjEDNj-ja ka kujtuar dhe ritheksuar çfarë kishte konstatuar në *Dallos v. Hungari*. Ajo konstatoi se ishte e pakontestueshme se deri në dënim, kërkuesi vërtet nuk ishte në dijeni se Gjykata Rajonale mund ta ri-cilësonte veprën penale si neglizhencë zyrtare. Kjo rrethanë sigurisht që ia uli mundësitë atij për tu mbrojtur nga akuza.

Megjithatë, GjEDNj-ja ka përsëritur se respektimi i nenit 6 duhet patjetër të përcaktohet në frymën e procedurave si tërësi, duke përfshirë procedurat e apelit. Në këtë lëndë, parashtruesi ka pasur të drejtë të kontestojë dënimin e vet për të gjitha aspektet relevante ligjore dhe faktike para Gjykatës së Apelit, e cila i ka dëgjuar palët në një shqyrtim të ankesës me gojë dhe i ka shqyrtuar ankesat e parashtruesit rreth riklasifikimit të akuzës nga të dyja pikëpamjet – procedurale dhe materiale. Nuk ishte pohuar se gjykatës së apelit i mungonte autorizimi për ta prishur dënimin dhe për ta liruar parashtruesin ose se në shkallën e apelit parashtruesi nuk kishte mundësi për ta mbrojtur veten ndaj akuzave të riformuluara. Fakti se deklaratat e parashtruesit kundër riklasifikimit kanë qenë të pasuksesshme nuk tregon se rishikimi i procedurave nuk ka mundur t'i ndreqë të metat e procedurës në shkallën e parë. Gjykata më tej deklaroi se kjo lëndë duhet patjetër të dallohet nga lënda *T. v. Austria* sepse në atë lëndë ankesat e parashtruesit kundër riklasifikimit janë refuzuar si prova që paraqesin fakte të reja të cilat ishin të papranueshme në apel dhe pa u mbajtur shqyrtimi i ankesës.

Në frymën e vendimeve të përmendura më lart, GjEDNj-ja është shumë e qartë duke theksuar se gjatë vlerësimit të efektivitetit të së drejtës në mbrojtje, e tërë procedura duhet patjetër të merret parasysh. Në qoftë se i pandehuri ka të drejtën në ankesë në të cilën mund të pretendojë atë e cila më herët nuk ka qenë e njohur për të ndërsa gjykata e apelit e ka mundësinë e shqyrtimit të lëndës dhe të ndryshimit të saj po qe se konstaton se gjykata e shkallës së parë ka gabuar në vendimin e saj, atëherë neni 6 nuk është shkelur.

Në frymën e kësaj jurisprudence, Gjykata e Apelit nuk mund të konsiderojë se janë shkelur të drejtat e të pandehurit. Nuk është gjetur asnjë vendim i GjEDNj-së e cila do ta mbështeste kundërshtimin e ankuesit ndaj aktgjykimit. Ai ka pasur të drejtën e ankesës ndërsa Gjykata e Apelit, pas mbajtjes së seancës ku ai ka pasur mundësinë e paraqitjes së argumenteve, mund ta shqyrtojë lëndën edhe nga aspekti i ligjit procedural edhe ai material; janë dhënë të gjitha mundësitë ligjore për ndryshimin apo madje edhe prishjen e aktgjykimit. Për këtë arsye nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës dhe nuk ka arsye për revokimin e dënimit plotësues. Fakti se i pandehuri nuk ka kundërshtuar bazat është tërësisht gabim i tij. Ai ka pasur mundësinë për parashtrimin e çfarëdo argumenti që ka dashur kundër dënimit të shqiptuar por zgjedhja e tij ka qenë që mos ta bëjë një gjë të tillë.

2. Mbrojtësja Rezarta Metaj (**N.M**) ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit përmban shprehje tjera dhe më të ashpra sesa ato që përmenden në aktakuzë, duke e tejkaluar aktakuzën. Gjithashtu i pandehuri **N.M** ka pohuar se përmbajtja e dispozitivit ka ndryshuar cilësimin e veprave penale të aktakuzës. Prokurori është përgjegjës duke deklaruar se dallimet janë vetëm formale dhe si pasojë e formulimit të ndryshëm jorelevant.

Faktet relevante për plotësimin e kushteve të veprave penale duhet patjetër të përfshihen në aktakuzës (neni 305 (1) (2) i KPP-së). Pasi të konfirmohet nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë do ta kufizojë objektin e shqyrtimit gjyqësor dhe faktet të cilat mund të shqyrtohen për vërtetimin e fajësisë në aktgjykim. Aktakuza mund të ndryshohet nga prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor por në atë rast mbrojtja do ta ketë të drejtën e dhënies së mendimit të saj dhe të paraqesë provat (neni 376 i KPP-së). Dispozitivi është pjesë e aktgjykimit e cila përmban vendimin e ekzekutueshëm dhe faktet relevante që konstatohet se janë vërtetuar (nenet 391 (1) 1) dhe 396 (3), (4) të KPP-së). Arsyetimi do t'i tregojë faktet të cilat janë vërtetuar dhe ato që nuk janë vërtetuar dhe provat e vlerësuara për ta arsyetuar vendimin (neni 396 (7) i KPP-së). Aktgjykimi mund të lidhet vetëm me faktet të cilat i përmban akuza (neni 386 (1) i KPP-së). Në qoftë se e tejkalon gjendjen faktike lidhur me veprat e ngarkuara, d.m.th. nëse dispozitivi përmban fakte të tjera nga faktet e aktakuzës, kjo do të çojë në shkelje esenciale të procedurës (neni 403 (1) (10) e KPP-së).

Por jo të gjitha ndryshimet e gjendjes faktike do të rezultojnë me shkelje procedurale. Ajo shkelje duhet të jetë esenciale dhe të ketë ndikim efektiv në të drejtat e mbrojtjes. Koncepti i “faktit” ka të bëjë me një ndodhi specifike natyrale apo me veprim njerëzor në kohë dhe hapësirë dhe jo me fjalët të cilat shfrytëzohen për përshkrimin e saj. Ajo që është me rëndësi është sigurimi i informatave të nevojshme për të pandehurin paraprakisht lidhur me faktet materiale për të cilat ai ose ajo akuzohet dhe të mundësuarit e kundërshtimit të këtyre fakteve dhe paraqitja e provave përkatëse mbështetëse. Pas leximit të aktgjykimit, Gjykata e Apelit është e mendimit se asnjë ndryshim me rëndësi i fakteve në dëm të të pandehurit nuk është i përfshirë në dispozitiv.

“Informata zyrtare” dhe “informata konfidenciale” nuk janë koncepte të ndryshme në esencë. Fakti me të cilin akuzohet i pandehuri është se ai ka zbuluar informata që lidhen me një hetim penal. Këto informata janë edhe zyrtare edhe konfidenciale. Prandaj, të dyja shprehjet e cilësojnë të njëjtin realitet me fjalë të ndryshme. E njëjta vlen edhe për “informatën” edhe për “informatën zyrtare”. Të gjitha informatat nga një lëndë e hetuar janë zyrtare – kjo është po ashtu edhe çështje e cilësimit. “Për t’i mundësuar” apo “me qëllim të” janë shprehje të barasvlershme për përshkrimin e veprimit të qëllimshëm të dikujt i cili synon arritjen e një rezultati të caktuar. “Mbajtje e kundërligjshme në posedim të armës” është cilësim juridik por jo fakt i ri. “Siç përcaktohet me ligj” po ashtu është një fakt bindës ligjor ama jo fakt. Gjykata e Apelit gjen se nuk ka ndryshim esencial të akuzave faktike në dispozitivin në fjalë.

3. Mbrojtësi Haxhi Millaku (**M.N**) ka pohuar se dispozitivi i aktgjykimit e ka tejkaluar akuzën, mirëpo nuk janë paraqitur argumente të tjera për mbështetjen e një pohimi të tillë.

Ndryshimet e përmendura më sipër tashmë kanë konsideruar të parëndësishme. Nuk ka të tjera që duhet adresuar.

Dispozitivi i pakuptueshëm apo i paqëndrueshëm / mungesa e arsytimit në aktgjykimin / mungesa e arsytimit lidhur me faktet materiale / paqartësia apo paqëndrueshmëria e arsytimit / mospërputhja në mes të arsytimit lidhur me përmbajtjen e dokumenteve apo dëshmime përkritazi me faktet materiale (neni 403 (1) (12) i KPP-së)

1. Mbrojtësi Bajram Tmava (**N.M**) ka pohuar se aktgjykimi është i paqëndrueshëm dhe i dykuptimtë për shkak të përsëritjes së referimeve në prova dhe për shkak të kundërshtimeve në mes të dispozitivit dhe arsytimit përkritazi me dashjen e të pandehurit për të fituar dobi pasurore të kundërligjshme dhe për të kërkuar çfarëdo shume parash. Nuk është thënë me saktësi se cilat pjesë të aktgjykimin nuk janë të kuptueshme.

Parakushtet ligjore të aktgjykimin me shkrim janë të përcaktuara me nenin 396 të KPP-së. Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, edhe nëse struktura formale e ndjekur nga gjykata e shkallës së parë është e diskutueshme, aktgjykimi i përmbush kushtet ligjore. Të gjitha elementet e pjesës hyrëse dhe të dispozitivit janë të përfshira. Është e vërtetë se në arsyetim nuk janë përmendur qartë, plotësisht dhe ndaras faktet e vërtetuara dhe faktet jo të vërtetuara si dhe arsytet për një vlerësim të tillë. Me leximin e plotë të dokumentit, megjithatë, është e mundur cilat fakte gjykata i ka vërtetuar si të provuara sepse ato tregohen në dispozitiv. Arsyetimi për vërtetimin e gjendjes faktike po ashtu është i pranishëm në aktgjykim, pasi që gjykata i ka analizuar të gjitha provat e ekzaminuara dhe i ka justifikuar arsyet pse disa nga provat janë të besueshme e disa jo.

Gjykata e Apelit pajtohet se aktgjykimi është i vështirë për t'u lexuar dhe për t'u kuptuar. Vendende përsëritet në disa pika dhe struktura formale e tij nuk përputhet me strukturën e përcaktuar me ligj. I mungon rendi logjik apo teknika e silogjizmit juridiko-penal: fakti, dispozita ligjore, pasoja, d.m.th. cilat fakte kanë ndodhur, si i ka konstatuar gjykata, pse vlejné ato për secilin përkufizim të veprës penale dhe pse është zgjedhur sanksioni i caktuar. Por, kjo nuk e bën aktgjykimin të pakuptueshëm; vetëm më të vështirë për t'u lexuar. Nuk ekziston shablloni ligjor apo forma e detyrueshme për ta shkruar një aktgjykim. Mund të ndiqet praktika gjyqësore e përdorur në sistemin përkatës juridik. Mbase, do të ishte e këshillueshme të ndiqen këto praktika për shkak se nëse shfrytëzohet një kod i përbashkët gjuhësor dhe konceptuar, juristët e atij sistemi do ta kenë më të lehtë për ta kuptuar më mirë vendimin. Por struktura formale e përcaktuar me ligj nuk është e detyrueshme deri në atë pikë sa mund të konsiderohet shkelje e rëndësishme procedurale nëse nuk respektohet si e tillë. Do të ishte ndryshe nëse përmes përdorimit të një strukture tjetër formale të aktgjykimin, gjykata do ta bënte të pamundur apo jashtëzakonisht të vështirë – në bazë të kriterëve të një pranuesi mesatar të vendimit – të kuptohej domethënia e tij dhe me këtë të rrezikohej nxjerrja e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të drejtë (neni 403 (2) i KPP-së). Por nuk e kemi një situatë të tillë. Ankuesit e kanë kuptuar aktgjykimin në atë mënyrë e cila iu mundëson atyre të deklarojnë mospajtimin e tyre dhe kontestimin e tij përmes parashtrimit të ankesave.

2. I pandehuri **N.M** ka pohuar se (i) ka kundërshti në mes të arsytimit dhe dispozitivit për shkak se emërtimi juridik i veprave penale nuk është i plotë dhe i drejtë, se (ii) koha dhe vendi i kryerjes nuk përcaktohen qartë dhe se (iii) faktet e vërtetuara janë kontradiktore.

Gjykata e Apelit nuk mund të pajtohet me pohimin e ankuesit se emërtimi juridik i veprave penale është jo i plotë dhe i gabueshëm. Ankuesi nuk ka ofruar motive të mjaftueshme se e ka kuptuar pohimin në fjalë.

Dispozitivi përfshin vendin dhe faktet të cilat kanë ndodhur: “*në Prishtinë*”, “*në Prizren në lokalin e tij në rrugën*”, “*në Prishtinë dhe në Gjakovë*” si dhe “*në hotelin ‘Nartel’ në Prishtinë*”. Po ashtu përfshihet edhe ora kur janë kryer krimet: “*në periudhën në mes të qershorit 2010 dhe datës 27 prill 2011*”, “*në periudhën para datës 11 shtator 2011*”, “*më 2 prill 2012*” dhe “*më 11 shtator 2011*”. Përcaktimi i orës dhe i vendit të veprave penale është i detyrueshëm në aktakuzës dhe në aktgjykim (nenet 305 (1) dhe (4) si dhe 391 (1) 1) të KPP-së). Këto elemente janë esenciale për mundësimin e ushtrimit të të drejtave të mbrojtjes dhe po ashtu për ta lejuar gjykatës verifikimin nëse janë plotësuar apo jo juridiksioni territorial dhe parashkrimi. Gjykata e Apelit gjen se mjafton indikacioni i referuar për ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes.

Në dispozitiv thuhet se i pandehuri ka vepruar me dashje për të përfituar dobi pasurore për vete ose për të tjerët ndërsa në arsyetim thuhet se nuk është vërtetuar se ai ka pranuar ndonjë pagesë ose ndonjë dobi pasurore ose se e bashkëpandehura **M.N** të ketë kërkuar ndonjë pagesë në emër të tij. Gjykata e Apelit konsideron se nuk ka kundërshti në deklarimin se dikush ka vepruar me një qëllim të caktuar por që nuk është demonstruar se në fakt ka ndodhur ai rezultat i synuar.

Sa u përket kundërshtive faktike, ankuesi nuk e ka përmbushur detyrën për të bërë pohime të mjaftueshme sa për të mundësuar vlerësimin e arsyeve të tij.

3. I pandehuri **X.Z** ka pohuar se arsyetimi lidhur me gjendjen faktike ka munguar dhe është i pamjaftueshëm.

Ky pohim nuk mbështetet me arsye konkrete. Siç është vërtetuar më lart, Gjykata e Apelit konstaton se aktgjykimi i shkallës së parë i ka mbështetur faktet të cilat janë konsideruar të vërtetuara lidhur me provat e shqyrtuara dhe ka prezantuar motivim të mjaftueshëm për ta arsyetuar vendimin në fjalë.

4. Mbrojtësi Haxhi Millaku (**M.N**) ka pohuar se gjendja e vërtetuar faktike nuk e mbështet aktgjykimin në dispozitiv.

Duke e lexuar ankesën del e qartë se ankuesi është duke e kundërshtuar gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata dhe jo mungesën e fakteve për përmbushjen e elementeve të veprave penale.

Moszbatimi apo zbatimi jo i drejtë i dispozitave procedurale i cili ndikon në marrjen e aktgjykimit ligjor / shkelja e të drejtave të mbrojtjes që ndikon në marrjen e aktgjykimit ligjor (neni 403 (2) 1) dhe 2) të KPP-së)

1. Mbrojtësi Bajram Tmava (N.M) ka pohuar disa shkelje të dispozitave procedurale. Gjykata e Apelit tash do t'i adresojë ato. Është pohuar se aktgjykimi nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 391 1.6 dhe 2 të KPP-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është në faqen 212. Vendimi lidhur me afatin e pagesës së gjobave është caktuar të jetë 30 ditë. Vetëm mungesa e vëmendjes së ankuesit ia mundëson Gjykatës së Apelit të kuptuarit e këtij kundërshtimi.

Lidhur me zëvendësimin e gjobës nëse nuk paguhet, sipas neneve 39 dhe 40 të KPK-së dhe 46 të KPRK-së, ligji përcakton disa alternativa për vendosje nga gjyqtari në një fazë të mëvonshme, sipas arsyeve të dhëna për arsyetimin e mungesës së pagesës dhe rrethanave të tjera specifike. Është e qartë se si rregull e përgjithshme, gjykata e shkallës së parë mund të mos presë vendimin i cili do të varet nga faktorët e ardhshëm. Për këtë arsye, duhet të kuptohet se obligimi që menjëherë të përmendet në aktgjykim forma e zëvendësimit të gjobës së papaguar zbatohet vetëm nëse gjykata tashmë i ka elementet për marrjen e atij vendimi, në vend se ta referojë çështjen për një fazë të mëvonshme, ashtu si është më e përshtatshme. Prandaj, nuk është bërë asnjë shkelje procedurale e rëndësishme.

Është pohuar se aktgjykimi nuk e ka bërë vlerësimin e të gjitha provave.

Ankuesi nuk ka deklaruar se cilat prova gjykata nuk i ka vlerësuar e që është dashur t'i vlerësojë. Duke i lexuar shkresat e lëndës, Gjykata e Apelit vëren se të gjitha provat e dorëzuara në mënyrën e duhur janë ekzaminuar dhe përmenden në aktgjykim. Nuk ka nevojë që gjykata ta vlerësojë secilën provë veç e veç deri në hollësitë më të vogla por në vend të kësaj të gjitha provat në mënyrë të përmbledhur, në veçanti ato të cilat gjykata i konsideron të jenë më të rëndësishme si dhe ato që janë konfliktuoze (neni 397 (6) i KPP-së). Gjykata mund të mos përmend fare ato prova absolutisht të parëndësishme të cilat nuk kanë kurrfarë vlere provuese.

Është pohuar se aktgjykimi në fjalë nuk i ka vlerësuar të gjitha argumentet e mbrojtjes.

Gjykata e shkallës së parë nuk është e obliguar që t'iu përgjigjet të gjitha argumenteve të prezantuara në fjalët përfundimtare të palëve. Ajo vetëm duhet t'i bëjë të ditura arsyet për mosmiratimin e propozimeve si dhe t'i japë arsyet për vendosjen e pikave ligjore (neni 396 (6)). Po qe se gjykata nuk e ka vlerësuar asnjë argument relevant, kjo gjë nuk e bën vendimin të pavlefshëm. I pandehuri gjithmonë do të ketë të drejtën të sjellë këtë argument për shqyrtim përmes ankesës.

Është pohuar se gjykata nuk ka angazhuar ekspertë profesionistë për të vlerësuar nëse veprimet e të pandehurit mund të konsiderohen gabime administrative apo jo në vend se të konsiderohen vepra penale.

Ky pohim, me gjithë respektin, është pothuajse absurd. Në bazë të nenit 175 të KPP-së, eksperti duhet të angazhohet në rastet kur një fakt i rëndësishëm kërkon gjetjen dhe mendimin e specialistit me njohuri të posaçme profesionale. Sipas ankuesit, vendimi nëse veprimet e tij kanë relevante sa i përket aspektit penal apo administrativ duhet të vlerësohet nga eksperti. Por Gjykata e Apelit nuk mundet në asnjë mënyrë të pajtohet me këtë përfundim. Pikërisht kjo është

detyrë e trupit gjykues në shqyrtimin gjyqësor, pra të gjejë nëse është kryer apo jo krimi. Kjo është qartë çështje e interpretimit ligjor ku gjyqtari është “ekspert i ekspertëve”.

Është pohuar se aktvendimi mbi nisjen e hetimeve i marrë më 27/3/2012 nuk i është dërguar mbrojtjes. Prokurori është përgjegjës se nëse për shkak të ndonjë gabimi dokumenti në fjalë nuk u është dërguar palëve, kjo është përmendur në aneksin e aktakuzës dhe kështu i pandehuri ka pasur rastin ta kërkojë atë gjatë gjykimit.

Në shkresat e lëndës nuk është gjetur asnjë fletëdërgesë. Pohimi në fjalë duket se është i saktë. Megjithatë, ligji nuk e parasheh si të detyrueshëm njoftimin. Nisja e hetimeve duhet t'i komunikohet vetëm gjyqtarit (nenet 221 (1) dhe 222 (2) të KPP-së). Vetëm në rast se hetimet nuk janë ndërprerë brenda gjashtë muajsh dhe gjyqtari nuk e pranon kërkesën e prokurorit për ta mbajtur sekret, atëherë aktvendimi do t'iu dërgohet palës mbrojtëse (neni 225 (3) dhe (4) i KPP-së).

Është pohuar se puna hetimore të cilën policia e ka kryer para nisjes së hetimeve përmes aktvendimit nuk është kryer nën mbikëqyrjen e prokurorit. Prokurori është përgjegjës duke thënë se ligji pranon hapat hetimorë nga policia para fillimit të hetimeve dhe se fakti që këto veprime kanë ndodhur para aktvendimit mbi fillimin e hetimeve nuk do të thotë se prokurori nuk ka qenë mbikëqyrës.

Mbikëqyrja e punës policore është e paraparë me nenin 200 (2) dhe (3) të KPP-së. Është e qartë se ligji i lejon disa veprime para aktvendimit mbi fillimin e hetimeve dhe se mbikëqyrja mund të bëhet në mënyrë joformale dhe verbale. Asnjë rrethanë nuk është ngritur e cila do të mund të shpinte në përfundimin se ka pasur ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të rregullt.

Është pohuar se gjykata nuk i ka dëgjuar dëshmitarët e rëndësishëm.

I pandehuri ka mundur të kërkonte marrjen në pyetje të dëshmitarëve në të gjitha fazat procedurale nëse do ta kishte konsideruar të rëndësishme marrjen e deklaratave të tyre (neni 239, gjatë hetimeve, 308, për shqyrtimin gjyqësor, dhe 360 (4), gjatë shqyrtimit gjyqësor), por nuk e ka bërë një gjë të tillë.

2. Mbrojtësja Rezarta Metaj (**N.M**) ka pohuar se në shkelje të dispozitave procedurale, gjykata gabimisht ka zbatuar kodin e mëhershëm procedural në vend të kodit i cili është në fuqi tani. Prokurori është përgjegjës se në bazë të nenit 545 (1) të KPP-së, kodi i revokuar është kodi në fuqi.

Sipas pikëpamjes së Gjykatës së Apelit, neni 545 i KPPK-së *a contrario* është i qartë duke theksuar se kodi në fuqi është kodi i revokuar.

3. Mbrojtësja e njëjtë Rezarta Metaj (**N.M**) po ashtu ka pohuar faktin se klientit të tij nuk i është dorëzuar vendimi për dhënien e statusit të dëshmitarit bashkëpunues **P.M**.

Aktvendimi kur është nxjerrë për herë të parë i është dërguar vetëm prokurorisë por jo edhe mbrojtjes. Kjo është përmendur gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe më 4 dhjetor 2012 të gjitha palët kanë marrë nga një kopje të tij. Njoftimi para shqyrtimit gjyqësor është i detyrueshëm (neni 302 i

KPP-së). Megjithëkëtë, ky lëshim është korigjuar dhe nuk është dhënë asnjë arsye për të besuar se aktgjykimi nuk ka qenë i drejtë apo i ligjshëm për shkak të mungesës së njoftimit me kohë.

4. I pandehuri **N.M** ka pohuar se ka pasur disa shkelje të dispozitave të procedurës të cilat Gjykata e Apelit do t'i shqyrtojë tani.

Është pohuar se i pandehuri nuk është përfaqësuar nga avokati gjatë marrjes në pyetje të të bashkëpandehurit **X.Z** më 18/4/2012.

Në bazë të procesverbalit, mbrojtësi Bekë Lajqi i **R.Z** është ftuar por nuk është paraqitur. Prania e mbrojtësit të të pandehurit gjatë marrjes në pyetje të të bashkëpandehurve nuk parashihet me ligj si prani e detyrueshme, zaten me nenet 73 dhe 231 të KPP-së, por si prerogativë diskrete e prokurorit (neni 237 (4) *a fortiori* si përjashtim i nenit 77 (3) të KPP-së). Nenet 156 (1) dhe 235 të KPP-së nuk i bëjnë të papranueshme provat në fjalë.

Është pohuar se prokurori ka vepruar në mënyrë të njëanshme.

Ky pohim është i pabazë. Dhe për të qenë të saktë, Gjykata e Apelit po ashtu e përkujton faktin se i pandehuri është dënuar nga gjykata dhe jo nga prokurori.

Është pohuar se gjykata ka refuzuar propozimin për t'i dëgjuar dëshmitarët me rëndësi: **I.A, E.G** dhe **Z.I**.

I pandehuri mund t'i propozojë dëshmitarët por duhet t'i justifikojë arsyet dhe ta bëjë të ditur çështjen (neni 322 (1) dhe (2) të KPP-së). Sa i përket dëshmitarit **I**, i pandehuri ka propozuar në shqyrtimin e 13 shkurtit 2013 se deklarata e tij e dhënë në fazën hetimore është konsideruar si e lexuar dhe e pranuar ndërsa gjykata e shkallës së parë e ka pranuar kërkesën në fjalë. Nëse deklarata nuk përmendet në aktgjykim, kjo gjë ndodh nga shkak se gjykata nuk e ka konsideruar provë relevante e jo për shkak se nuk është shqyrtuar si provë. Sa u përket dy dëshmitarëve të tjerë, procesverbali tregon se nuk është parashtruar asnjë kërkesë por është paraqitur vetëm një sugjerim i cili më vonë është tërhequr. Po të ishte i pandehuri shumë i interesuar për t'i marrë në pyetje këta dëshmitarë nuk do ta kishte tërhequr sugjerimin as nuk do të kishte thënë se nuk kishte pasur prova të tjera për të propozuar kur gjykimi kishte arritur tek paraqitja e fjalëve përfundimtare.

Është pohuar se paraqitja e fjalës përfundimtare të të pandehurit është kufizuar në mënyrë të kundërligjshme.

Gjykata e Apelit ka shqyrtuar procesverbalin e seancave dhe konstaton se me të drejtë është kufizuar fjala përfundimtare me një vërejtje për t'u fokusuar në pohimet të cilat janë relevante për lëndën. Kjo kompetencë i jepet kryetarit të trupit gjykues (neni 382 (2) të KPP-së) dhe e njëjta është përdorur me maturi dhe në mënyrë adekuate.

Është pohuar se gjykata nuk i ka vërtetuar faktet në favor të të pandehurit.

I pandehuri ka mundur t'i parashtrtojë faktet në shqyrtim gjyqësor në bazë të dispozitave të neneve 308, 309 (4) dhe (5) si dhe 311 të KPP-së). Po ta kishte bërë një gjë të tillë, gjykata do të ishte obliguar t'i adresonte këto fakte dhe t'i përfshinte në aktgjykim si të provuara apo të

paprovuara. Por ai nuk e bëri këtë dhe tash nuk ka mundësi të dihet se për të cilat fakte e ka fjalën. Neni 7 i KPP-së nuk mund të thirret për t'i mbështetur pohimet e të pandehurit pasi që ky nen parashikon mundësinë vetëm *ex officio* në qoftë se gjykata e gjen të përshtatshme dhe të domosdoshme.

5. I pandehuri **R.Z** ka pohuar se në shkelje të dispozitave të procedurës aktakuza nuk i plotëson kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 305 të KPP-së.

I pandehuri nuk e ka përmendur se cilat parakushte nuk janë plotësuar. Gjykata e Apelit është e mendimit se aktakuza i plotëson kushtet ligjore.

6. Mbrojtësi Kastriot Spahiu (**X.Z**) ka pohuar se në shkelje të dispozitave procedurale aktgjykimi nuk e përshin kohën e kaluar në paraburgim ose mënyrën e zëvendësimit të gjobës së shqiptuar. Prokurori është përgjigjur se neni 391 (1) (5) i KPP-së i referohet vetëm paraburgimit të caktuar në bazë të vendimeve të mëhershme të sjella në procedura të tjera.

Ankuesi nuk e ka mirë dhe pohimi i tij duhet të jetë rezultat i mungesës së vëmendjes pasi që në faqen 24 të aktgjykimit thuhet se koha e kaluar në paraburgim do t'i llogaritet në vuajtje të dënimit.

4.2 Shkelja e ligjit penal

A ka qenë veprimi vepër penale apo jo (neni 404 1) i KPP-së)

1. Mbrojtësja Rezarta Metaj (**N.M**) ka pohuar se qëllimi për të përfituar dobi pasurore lidhur me veprën e parë penale nuk është provuar dhe se, sa i përket veprës së dytë penale, faktet e mbështesin cilësimin e krimit si një tentativë. Prokurori është përgjigjur duke deklaruar se vepra penale e nenit 339 (1), (3) të KPK-së nuk kërkon që vetë kryerësi të përfitojë dobi pasurore pasi që mjafton që personi i tretë ta përfitojë në përputhje me dashjen e kryerësit. Lidhur me veprën e dytë penale, prokurori ka shtuar se fakti që është provuar bartja e parave nuk do të thotë se veprimi në fjalë nuk është përfunduar për shkak se kushti ligjor është një veprim me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore. Prokurori i apelit e ka dhënë mendimin e tij se elementet konstitutive të krimeve janë vërtetuar.

Faktet që lidhen me qëllimin kriminal të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, janë të përshkruar në dispozitivin: *“me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për veten, X.Z dhe R.Z në vlerë prej 50.000 Euros (...)”*. Prandaj, dënimi i të pandehurit është mbështetur në faktin që gjykata e ka konstatuar të vërtetuar. Përndryshe, i pandehuri mund të pretendojë se provat nuk kanë qenë të mjaftueshme për ta provuar qëllimin në fjalë. Por kjo është një çështje tjetër e cila ka të bëjë me vlerësimin e provave të cilat do të analizohen paraprakisht.

Lidhur me pohimin se vepra e dytë penale duhet të cilësohet si tentativë dhe jo si krim i përfunduar, Gjykata e Apelit e konsideron të gabuar. Veprimi i cili i përmbush elementet e veprës penale të nenit 339 të KPK-së është keqpërdorimi i pozitës zyrtare, autorizimet e tepërta dhe moskryerja e detyrave nga personi zyrtar me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore ose shkakimit të dëmit. I pandehuri është dënuar për shkak se është vërtetuar se me

qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, në cilësinë e prokurorit, ia ka zbuluar të pandehurit informatën lidhur me hetimin me qëllim që ajo t'i kontaktojë të dyshuarit dhe t'iu kërkojë para nëse dëshirojnë ndërprerje të hetimeve. Është e qartë se përfitimi i dobisë pasurore nuk është kusht për këtë krim; mjafton vetëm qëllimi për të.

Nga ana tjetër, sipas nenit 20 të KPK-së, kemi të bëjmë me tentativë kur veprimi nuk është kryer apo kur elementet e veprës së synuar penale nuk janë përmbushur. Kjo nuk ka ndodhur për shkak se duke i shfrytëzuar informatat e lidhura me hetimin me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në këmbim të ndërprerjes së kundërligjshme të atij hetimi, veprimet e të pandehurit kanë kompletuar elementet e veprës penale, pavarësisht faktit se nuk është provuar se kjo dobi pasurore vërtet është përfituar.

2. I pandehuri **N.M** ka pohuar se aktgjykimi është zbatuar paralelisht sipas dy ligjeve, edhe sipas ligjit penal të “vjetër” dhe atij të “ri” në dëm të tij.

Gjykata thjesht për veprat penale për të cilat i pandehuri është dënuar me ligjin ka zbatuar ligjin më të favorshëm, sipas parimit të nenit 3 të KPRK-së. Ky pohim është vështirë të kuptohet, pasi që i pandehuri nuk e ka shpjeguar arsyen pse zbatimi i ligjit më të favorshëm ka rezultuar të jetë në dëm të tij.

3. Po ashtu avokati mbrojtës Kastriot Spahiu (**X.Z**) ka argumentuar se faktet nuk i mbështesin veprat penale dhe se ato lidhen vetëm me një kontest civil.

Ky pohim mbase mund t'iu referohet fakteve të cilat sipas mendimit të ankuesit është dashur të vërtetohen tashmë dhe jo atyre të cilat gjykata vërtet i ka vërtetuar. Kundërshtimi në fjalë duket se nuk bie në kundërshtim me cilësimin juridik të veprave penale në fjalë por në të vërtetë e kundërshton vërtetimin e gjendjes faktike.

4. Mbrojtësi Haxhi Millaku (**M.N**) ka pretenduar se veprat penale në fjalë janë cilësuar gabimisht.

Ky është një pohim vendimtar i cili nuk mbështetet në pretendimet specifike të vlerësuara nga Gjykata e Apelit. Të gjitha elementet e domosdoshme faktike të veprave penale për të cilat i pandehuri është shpallur fajtorë janë të përshkruar në dispozitiv.

A ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë ndjekjen penale, në veçanti përjashtimin për shkak të arritjes së afatit të parashkrimit, të amnistisë, të faljes apo *res judicata* (neni 404 3 i KPP-së)

Prokurori dhe prokurori i apelit i kanë propozuar Gjykatës së Apelit anulimin e akuzës e cila ka të bëjë me veprën penale të mbajtjes së paautorizuar në pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të armëve sipas nenit 374 (1) të KPRK-së.

Në bazë të nenit 415 (1) 4) të KPP-së, këtë çështje Gjykata e Apelit e shqyrton në bazë të detyrës së vet zyrtare, pra *ex officio*. Nenet 2.1 dhe 3.1.1.10 të Ligjit mbi amnistinë e përjashtojnë nga ndjekja penale veprën penale të përcaktuar me nenin 374 (1) të KPRK-së. Asnjë prej përjashtimeve në nenin 4 të Ligjit mbi amnistinë nuk janë të zbatueshme. Prandaj, aktakuza lidhur me pikën 3 ndaj të pandehurit **N.M** duhet të refuzohet.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin a i ka tejkaluar gjykata autorizimet e veta ligjore (neni 404 5 i KPP-së)

Shkelja e ligjit penal në këtë drejtim nuk është kundërshtuar në ankesa. Megjithëkëtë, Gjykata e Apelit mund ta shqyrtojë këtë shkelje *ex officio* në bazë të nenit 415 (1) 4) të KPP-së dhe në këtë rast aktgjykimi ka pësuar shkelje të ligjit në dëm të të pandehurve, e cila duhet të korrigjohet.

Të gjithë të pandehurit janë dënuar me gjobë prej 10.000 eurosh. **N.M** dhe **M.N** për veprën penale nga neni 339 (1) i KPK-së, ndërsa **R.Z** e **X.Z** për veprën penale nga neni 345 (1) i KPK-së. Megjithatë, dispozitat ligjore në fjalë nuk e autorizojnë shqiptimin e gjobës ndaj të pandehurve. Sipas nenit 339 (1) dënimi për krimin është burgim deri në një vit, ndërsa nuk lejohet shqiptimit i gjobës. Sipas nenit 345 (1) dënimi është dënim me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Gjoha është dënim alternativ ndaj dënimit me burgim. Kjo gjë do të thotë se të pandehurit janë dënuar me sanksione të cilat nuk parashihen me ligj. Në mënyrë absolute nuk është dhënë asnjë arsye në aktgjykim e cila mbase do t'ia bënte të mundur Gjykatës së Apelit ta kishte të qartë këtë opsion. Ka mundësi që gjykata e shkallës së parë ka pasur si qëllim ta shqiptojë dënimin plotësues me gjobë në bazë të nenit 54 (2) 1) të KPK-së. Por po të kishte qenë puna asisoj, vendimi është dashur të ishte i qartë dhe i motivuar për t'iu mundësuar të pandehurve ushtrimin e së drejtës së tyre për t'u ankuar². Për shkak të faktit se Gjykata e Apelit nuk mund të supozojë se të pandehurit janë dënuar me gjobë në formë të dënimit plotësues dhe duke pasur parasysh se veprat penale për të cilat të pandehurit janë dënuar nuk pranojnë shqiptimin e gjobave, dënimi në fjalë duhet të revokohet në raport me të gjithë të pandehurit.

4.3 Vërtetimi i gabueshëm apo jo i plotë i gjendjes faktike (neni 405 (2) i KPP-së)

Të gjithë ankuesit e kanë kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vërtetimit të fakteve. Shkurtimisht, ata kanë pretenduar këto arsye lidhur me pohimin për vërtetim të gabueshëm të fakteve:

Mbrojtësi Bajram Tmava (**N.M**): dëshmia e **P.M** nuk është e besueshme për shkak të kontradiktave dhe mospërputhjeve; dëshmia e **S.M** nuk është e besueshme për shkak të kundërshtive dhe mospërputhjeve dhe për faktin se ai është vëllai i **P.M** pa pasur njohuri të drejtpërdrejtë mbi faktet; dëshmitë e **L.N**, **G.H**, **S.K**, **S.H**, **L.Z**, **V.L**, **A.L**, **L.K**, **A.G**, **T.G**, **P.P**, **B.B** dhe **Z.I.G** nuk janë të besueshme për shkak të kundërshtive dhe mospërputhjeve; provat materiale janë vlerësuar gabimisht; mbrojtja e të akuzuarve është injoruar gabimisht; ka mungesë të provave në rastin e **M.N**;

Mbrojtësja Rezarta Metaj (**N.M**): nuk ka prova mbi qëllimin e të pandehurit për përfitimin e dobisë, se ka qenë i përfshirë në aranzhimet e të bashkëpandehurve **R.Z** dhe **X.Z** ose se autorizimi i dhënë **P.M** për të shkuar në dasmë derisa ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak ka qenë i lidhur me aktivitetet e tjera me para; dëshmia e **T.G** e vërteton se i pandehuri ka vepruar

² Gjykata e Apelit e ka lexuar procesverbalin e këshillimit të kolegjit të shkallës së parë, nëse do të kishte mbase ndonjë sqarim të çështjes në fjalë. Por, meqenëse procesverbalin nuk mund t'iu zbulohet palëve, si i tillë nuk është vend i duhur për arsyetimin e vendimeve të marra të shkruara në aktgjykim nga kolegji.

vetëm nga pakujdesia; e bashkëpandehura **M.N** ka konfirmuar se i pandehuri nuk i kishte zbuluar asnjë informatë; dëshmitë e **S.M** dhe të **Z.I** e konfirmojnë mohimin e të pandehurit;

I pandehuri **N.M**: **P.M** ka dhënë dëshmi të rrejshme; dëshmia **L.N** nuk është e besueshme; dëshmitë e **S.K**, **L.Z**, **S.H**, **S.M**, **A.L** dhe **A.G** janë vlerësuar gabimisht; komunikimet telefonike janë vlerësuar gabimisht;

Mbrojtësi Zeqir Berdyna (**R.Z**): dëshmia e **P.M** është vlerësuar gabimisht për shkak se faktet janë të lidhura vetëm me kontest civil;

I pandehuri **R.Z**: dëshmitë e **L.N**, **G.H**, **S.M** dhe **T.G** nuk janë të besueshme;

Mbrojtësi Kastriot Spahiu (**X.Z**): telefoni i të pandehurit është shfrytëzuar nga personat e tjerë: dëshmia e **P.M** nuk është e besueshme; provat janë vlerësuar gabimisht;

I pandehuri **X.Z**: **P.M** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe se të gjitha provat janë vlerësuar gabimisht;

Mbrojtësi Haxhi Millaku (**M.N**): provat janë vlerësuar gabimisht.

Prokurori është përgjigjur duke theksuar se janë prezantuar prova të mjaftueshme dhe se provat rrethore janë të mjaftueshme për ta mbështetur dënimin. Prokurori i apelit ka dhënë mendimin se gjykata i ka vlerësuar drejt provat.

Duke i lexuar ankesat mbase mund të fillojmë të kujtojmë se asnjë dëshmitar i vetëm nuk e ka thënë të vërtetën para gjykatës dhe se e vetmja provë e besueshme është mohimi i të pandehurve. Thellë në vete, pohimet e ankuesve nuk janë asgjë tjetër pos manifestime të mospranimit dhe mospajtimit me aktgjykimin e prezantuar në mënyrë bindëse dhe jo të mbështetur në motive konkrete.

Rishikimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë lidhur me vërtetimin e fakteve është i lidhur me pohimet e ankuesve, pasi që kjo nuk është çështje të cilën Gjykata e Apelit mund ta ekzaminojë *ex officio* (neni 415 (1) i KPP-së *a contrario sensu*). Ankuesit duhet, sipas tekstit në ligj të ofrojnë “një sqarim të ankesës” (neni 401 (10 3) i KPP-së). Motivimi i ankesës për kundërshtimin e fakteve të vërtetuara duhet patjetër të jetë preciz dhe të sqarojë qartë se cilat prova do të tregonin se një fakt i caktuar është dashur të ishte konsideruar i provuar apo jo dhe arsyeja pse. Ligji nuk iu jep palëve të drejtën në aktgjykimin e dytë por vetëm mundësinë për rishikim të aktgjykimit, gjë e cila nuk është njësoj. Gjykata e Apelit nuk pritet që ta përsërisë shqyrtimin e të gjitha provave sikur të mos ekzistonte fare aktgjykimi i mëparshëm.

Siç është vërtetuar paraprakisht nga Gjykata e Apelit³, kur neni 405 i KPP-së i përkufizon shprehjet “vërtetim i gabueshëm i gjendjes faktike” dhe “vërtetim jo i plotë i gjendjes faktike”, ky nen iu referohet gabimeve dhe lëshimeve që lidhen me “faktet materiale” të cilat janë të

³ PAKR 1121/12, aktgjykimi i datës 25/09/2013.

rëndësisë vendimtare për të arritur gjer tek aktgjykimi⁴. Gjykata e Apelit e kthen (anulon) aktgjykimin vetëm nëse gjykata e shkallës së parë ka bërë ndonjë gabim themelor gjatë vlerësimit të provave dhe vërtetimit të fakteve.⁵

Si parim i përgjithshëm, vlerësimi i provave duhet të mbështetet në shqyrtimin e drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të dëshmimeve dhe deklaratave verbale nga ana e kolegjit të gjyqtarëve. Të lexuarit e procesverbalit të provave të shqyrtuara në gjykim, sado që mund të jetë besnik dhe i saktë, gjithmonë është një mjet më pak i besueshëm për vlerësimin e provave. Qoftë edhe shqyrtimi i dokumenteve dhe i provave të tjera materiale është në përgjithësi më i saktë në gjykim për shkak se shpesh këto prova duhet të bashkohen me elementet e tjera dhe janë objekt i sqarimeve verbale nga ana e dëshmitarëve ose palëve. Për këtë arsye, siç është vërtetuar nga kjo gjykatë në rastet e tjera⁶, *“është parim i përgjithshëm në procedurat e apelit që Gjykata e Apelit duhet patjetër të tregojë një dozë respekti për gjetjen faktike të trupit gjykues sepse pikërisht këta të fundit kanë qenë në pozitë më të mirë për t’i vlerësuar provat”*. Gjykata Supreme e Kosovës është e pikëpamjes se duhet patjetër *“ta respektojë vlerësimin e trupit gjykues të besueshmërisë së dëshmitarëve të gjykimit të cilët janë paraqitur dhe kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e drejtë për Gjykatën Supreme të Kosovës që ta refuzojë vlerësimin e trupit gjykues të besueshmërisë së atyre dëshmitarëve nëse nuk ka një bazë të fortë për të bërë diçka të tillë.”* Standardi të cilin Gjykata Supreme e ka zbatuar ka qenë *“të mos i prekë gjetjet e trupit gjykues nëse provat mbi të cilat është mbështetur gjykata nuk kanë mundur të pranohen nga çfarëdo gjykatë faktike, ose kur vlerësimi i saj ka qenë plotësisht i gabueshëm”*.⁷

Gjykata e Apelit i ka rishikuar të gjitha provat e shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë dhe vlerësimin e bërë nga ana e kolegjit në aktgjykim. Është e qartë se ka kundërshti dhe mospërputhje në mes të deklaratave. Dëshmitarët nuk kanë përdorur në të gjitha rastet saktësisht të njëjtat fjalë kur kanë dhënë deklaratat në rastet e ndryshme, prandaj jo të gjitha deklaratat përputhen qind për qind. Kjo është krejt normale në raste të tilla, pasi që drejtësia nuk është shkencë ekzakte si matematika për shembull. Në veçanti kur faktet lidhen me ngjarje të cilat kanë ndodhur në fshehtësi dhe kur gjykata duhet domosdo të mbështetet në prova rrethanore apo indirekte.

Aktgjykimi i apeluar, në mendimin e Gjykatës së Apelit, nuk ka pësuar ndonjë gabim të ndjeshëm rreth vlerësimit të provave dhe vërtetimit të fakteve. Ankuesit nuk kanë treguar se gjykata e shkallës së parë ka gabuar apo nuk e ka vërtetuar plotësisht gjendjen faktike. Krejt çka kanë bërë ata ishte ndriçimi i ndonjë prove të caktuar duke e nxjerrë nga konteksti i përgjithshëm, duke injoruar provat tjera kontradiktore madje edhe rregullat e interpretimit sipas logjikës së shëndoshë, duke nxjerrë konkluzione të cilat janë të papranueshme. Askush nuk ka qenë dëshmitar i drejtpërdrejtë i fakteve të kontestuara dhe të pandehurit, përveç njërit prej tyre,

⁴ Aktgjykimi i përmendur më sipër i referohet autorit B. Petric, në tekstin: komentimet e neneve të procedurës penale të ligjit jugosllav, botimi i dytë i vitit 1986, neni 366, par. 3.

⁵ PaKr 1122/12, aktgjykimi i datës 25.04.2013.

⁶ PAKR 1121/12, aktgjykimi i datës 25/09/2013.

⁷ Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, par. 30.

kanë zgjedhur të mos japin deklarata në shqyrtimin gjyqësor. Si pasojë e kësaj, faktet vendimtare janë vërtetuar duke u mbështetur në vlerësimin e provave indirekte. Por ky është instrument i vlefshëm dhe i ligjshëm për të arritur deri tek siguria përtej dyshimit të arsyeshëm nëse plotësohen kushtet e caktuara. Numri i provave indirekte duhet patjetër të jetë i konsiderueshëm, të gjitha elementet rrethore duhet patjetër të jenë të qëndrueshme dhe kompakte nga brenda, të gjitha provat indirekte duhet të shpijnë në të njëjtin drejtim dhe konkluzion, provat indirekte të vlerësuara së bashku sipas kriterit të logjikës së shëndoshë, duhet patjetër të shpijnë tek konkluzioni se fakti i caktuar është paraqitur si shpjegim i vetëm i mundshëm dhe i arsyeshëm për provat në fjalë.

Deklaratat e të pandehurve dhe dëshmitarëve, të dyja të dhëna gjatë fazës hetimore si dhe në shqyrtimin gjyqësor, janë shqyrtuar në hollësi nga gjykata e shkallës së parë. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me komunikimet telefonike, regjistrimin dhe transkriptimin e porosive telefonike. Provat e dokumentuara të mjekësisë ligjore po ashtu janë vlerësuar me kujdes. Aktgjykimi e sqaron në mënyrë të detajuar çfarë kuptimi kanë ato prova dhe kontradiktat në mes tyre në një mënyrë aq bindëse sa të shtyjnë Gjykatën e Apelit të pranojë se faktet e vërtetuara në aktgjykim si të provuara janë shpjegimi i vetëm i arsyeshëm, logjik dhe i mundshëm për provat në fjalë. Si përfundim, konstatohet se aktgjykimi nuk ka pësuar vërtetim të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

4.4 Caktimi i gabueshëm i dënimit (neni 406 i KPP-së)

Gjykata e Apelit vëren se aktgjykimi ka pësuar dy gabime substanciale në faqen 207 (X. DËNIMI). Referimi i bëhet pikës 2 ndaj **N.M** se si ligj më i favorshëm është zbatuar kodi i ri penal. Por një gjë e tillë është gabim i qartë pasi që referimi i bëhet pikës 3 dhe asaj 2. E njëjta gjë vlen edhe për referimin se kodi i ri është zbatuar vetëm në një pikë kundër **M.N** për shkak se ajo është dënuar për veprën penale të nenit 339 (1) të kodit penal të vjetër. Gabimet e shtypit nuk janë relevante dhe nuk shkojnë në dëm të të pandehurve.

Dënimet e shqiptuara në aktgjykim janë kundërshtuar në emër të të gjithë të pandehurve, duke u bazuar në mungesë të proporcionalitetit dhe të drejtësisë si dhe mosmarrje parasysh të rrethanave lehtësuese. Prokurori i apelit ka dhënë mendimin e vet se dënimet në fjalë janë të drejta dhe të mbështetura në të gjitha rrethanat e vlerësuara.

Gjykata e Apelit tashmë ka theksuar se dënimet me gjobë duhet të tërhiqen. Prandaj, tash do të jetë e nevojshme vetëm të vlerësohet korrektësia e dënimeve me burgim, e dënimit plotësues të ndalesës së ushtrimit të çfarëdo funksioni të administratës publike apo shërbimit publik dhe e sekuestrimit të gjësendeve.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ka dhënë motivim të detajuar për dënimet madje as nuk iu është referuar dispozitave ligjore në fuqi siç ka qenë e obliguar me nenin 396 (8) të KPP-së. Disa nga rrethanat relevante për përcaktimin e dënimit janë përmendur lidhur me secilin të pandehur⁸ por pa ndonjë indikacion të vlerës apo kuptimit të tij – madje pa sqaruar nëse të tilla rrethana

⁸ Kreu X. Caktimi i dënimit, faqet 207 deri në 210.

janë vlerësuar si rrethana lehtësuese apo rënduese. Ligji nuk mjafton të ketë thjesht një indikacion përshkrues dhe neutral të rrethanave lehtësuese apo rënduese, pasi që kjo nuk është sqarim i arsyeve të cilat kanë sjellë deri tek vendimi. Megjithatë, pasi që aktgjykimi nuk është krejtësisht i heshtur në këtë drejtim dhe ekziston mundësia për t'i vlerësuar rrethanat dhe për ta ndryshuar vendimin nëse një gjë e tillë është e nevojshme në fazën e apelit, Gjykata e Apelit nuk e ka parë të udhës ta anulojë aktgjykimin vetëm për këtë arsye.

Sipas dispozitave të KPRK-së, parimet në fuqi për llogaritjen e dënimit janë këto:

- Sanksioni penal është mjeti i fundit për mbrojtjen e vlerave shoqërore dhe ky nuk mund të ndërhyjë përtej asaj që konstatohet si patjetër e domosdoshme. Sanksioni nuk guxon të jetë më i lartë sesa domosdoshmëria e zbatimit të drejtësisë dhe jopropocional me faktin i cili i ka rrezikuar vlerat shoqërore të mbrojtura. Për këtë arsye, në bazë të parimit të intervenimit minimal të sanksionit penal, duhet patjetër të supozohet se dënimi më i ulët i parashikuar me ligj do të jetë i mjaftueshëm, adekuat dhe normal për situatat standarde të cilat mund të përfshihen në dispozitën inkriminuese ligjore (neni 1).

- Qëllimet e dënimit janë që të sigurojë parandalimin dhe rehabilitimin e individit, të sigurojë parandalimin e përgjithshëm, të shprehë mosmiratimin shoqëror ndaj shkeljes së vlerave të mbrojtura shoqërore si dhe forcimin e ndjenjës së respektit shoqëror për ligjin (neni 41).

- Gjatë caktimit të dënimit, dënimi maksimal konkret do të jepet në bazë të shkallës së fajit të kryerësit ndërsa minimal në bazë të intensitetit të kërkesave për t'u qortuar nga shoqëria. Në kuadër të këtij kufiri të ri, sanksioni nuk guxon të jetë në kundërshtim me parimet e referuara të parandalimit dhe të rehabilitimit dhe duhet t'i marrë parasysh në mënyrë proporcionale të gjitha rrethanat specifike lehtësuese dhe rënduese të cilat kanë të bëjnë me faktin penal si dhe sjelljen dhe rrethanat personale dhe shoqërore të kryerësit.

Sipas dispozitave të KPK-së, parimet në fuqi nuk kanë ndonjë dallim të madh. Nuk ekziston dispozitë e barasvlershme me nenin 1 të KPRK-së, por kushtet e njëjta janë të pandara prej parimit kushtetues të proporcionalitetit. Sa i përket qëllimit të dënimit, neni 34 nuk bën fjalë asgjë lidhur me shprehjen e mospajtit shoqëror me krimin por po ashtu ky është një parim i cili lidhet nga brenda me qëllimin shoqëror të ligjit penal. Rregullat për matjen e dënimit në nenet 64 dhe 65 janë të shprehura në mënyrë koncize por domethënia e tyre në esencë mbetet e njëjtë.

Gjykata e Apelit tash do ta bëjë vlerësimin e elementeve përkatëse për përcaktimin e dënimeve adekuate për secilin të pandehur dhe secilën vepër penale, në bazë të rregullave në fuqi të KPK-së dhe KPRK-së.

N.M

Ka qenë prokuror me detyra zyrtare por një rrethanë e tillë nuk mund të vlerësohet rënduese për shkak se është konsideruar tashmë se veprimet e tij janë të përfshira në elementet e veprës penale. E njëjta gjë vlen edhe për qëllimin e tij për të përfutuar dobi pasurore, pasi që edhe ky është një element i krimit të cilin ai e ka kryer. Megjithatë, duhet domosdo të llogaritet si

rrethanë rënduese fakti se ai ka punuar në sistemin e drejtësisë dhe ka pasur detyra të veçanta profesionale për vënien në vend të drejtësisë, ndërsa me veprimet e veta e ka dobësuar shumë besimin e dhënë.

Faktet se ai ka kryer dy vepra penale, se ka qenë i përfshirë me tre të bashkëpandehur të tjerë dhe se veprimet e veta kanë ndodhur brenda një periudhe bukur të gjatë kohore tregon fajësinë e tij të konsiderueshme dhe intensitetin e rrezikut, që po ashtu llogaritet si rrethanë rënduese.

Vepra e parë penale ka rezultuar në humbje të konsiderueshme të parave të viktimës. Pavarësisht se kush ka përfituar me këto para, kjo gjë llogaritet si një faktor rëndues.

Veprimet e të pandehurit kanë qenë disi të motivuara, apo së paku të lehtësuara, nga rrethana të ndjeshme personale me të cilat ai është përballur si pasojë e sëmundjes së rëndë të të birit. Është e qartë nga provat se qëllimi i përfitimit të dobisë pasurore ka qenë i lidhur pikërisht me situatën në fjalë. Me këtë nuk mund të justifikohet veprimi në fjalë por kjo mund të llogaritet si faktor lehtësues i cili lidhet me shkallën e fajësisë.

Në të njëjtën kohë, sëmundja e të birit duhet të vlerësohet në favor të të pandehurit, së bashku me faktin se ai ka familje – gruan dhe tre fëmijët. Jo për shkak se kjo pasqyrohet drejtpërdrejt në cilësimin e veprimeve të tija kriminale por për shkak se ky është një faktor i fuqishëm parandalues pasi që i pandehuri tash e ka provuar burgimin dhe është në dijeni rreth faktit se çdo përsëritje në të ardhmen e sjelljes penale prapë mund të vendosë të birin e tij si dhe tërë familjen e tij në një situatë pa mbrojtje.

Nuk është provuar se në fund, i pandehuri ka përfituar ndonjë dobi pasurore nga veprimi i vet me rastin e veprës penale të parë. Në veprën e dytë penale madje as që ka pasur fare humbje materiale. Kjo ka mund të ndodhë për shkak të rrethanave jashtë vullnetit të vij, por objektivisht situata është më pak e kundërligjshme.

I pandehuri nuk është dënuar më herët dhe duke qenë kryerës i veprës për herë të parë, ky është një faktor lehtësues.

Në fund, sjellja e tij e mirë gjatë gjykimit po ashtu ka rëndësi. Jo pse nuk është pritur diçka e tillë prej tij porse duke vepruar kështu, i pandehuri ka treguar se disi ai është pajtuar me nevojën e pranimin të pasojave të veprimeve të veta derisa është përballur me gjykimin, që është pikërisht çasti kur në mënyrë publike është vendosur përballë qortimit nga ana e shoqërisë.

Duke i pasur këta faktorë parasysh, Gjykata e Apelit konsideron se as fajësia e të pandehurve as nevoja për parandalimin dhe qortimin nga shoqëria mund të arsyetojnë sanksionin prej 4 vjetësh për veprën e parë penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit. Kufijtë shtrihen nga 6 muaj deri në 5 vjet, prandaj katër vjet janë shumë afër maksimumit dhe përmbi shkallën e fajësisë. Duke i matur rrethanat rënduese në një rrafsh standard si dhe rrethanat e rëndësishme lehtësuese, sanksioni adekuat dhe proporcional vendoset në tre (3) vjet burgim.

Për arsye më të forta, një (1) vit burgim i shqiptuar për veprën e dytë penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit nuk është i pranueshëm. Gjykata e shkallës së parë duke e

shqiptuar dënimin më të ashpër të mundshëm, nuk i ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese të cilat vetë i kishte theksuar në aktgjykim. Gjykata e Apelit, duke e konsideruar kryesisht se nuk ka pasur humbje të parave në këtë vepër penale, e konsideron si të mjaftueshëm sanksionin prej tetë (8) muajsh burgim.

Si dënim plotësues, duke e pasur parasysh minimumin prej 3 (tre) vjetësh dhe maksimumin prej 3 vjet e tetë (8) muajsh, dënim adekuat është të shqiptohet burgimi prej 3 vjet e 6 muajsh burgim.

I pandehuri është dënuar me dënimin plotësues të ushtrimit të çfarëdo funksioni në administratën publike apo shërbimin publik për një afat prej tre (3) vjetësh pas vuajtjes së dënimit me burgim. Ky sanksion është shqiptuar në bazë të nenit 56 (2) të KPPK-së. Shqiptimi i sanksionit në fjalë nuk është i detyrueshëm por në lëndën në fjalë Gjykata e Apelit e konsideron sanksion adekuat. Shkelja e detyrave publike ka qenë shumë e rëndë ndërsa nevoja për sigurimin e besimit publik në institucione siç është sistemi gjyqësor është e konsiderueshme. Periudha kohore prej tre vjetësh nuk është e kontestueshme, duke i pasur parasysh veprimet e të pandehurit.

R.Z dhe X.Z

Gjykata e Apelit gjen se rrethanat e zbatueshme për të dy të pandehurit në fjalë janë në esencë të barasvlershme.

Ata janë personat të cilët kanë pranuar dobinë e kundërligjshme pasurore në vlerën prej 30.250 eurosh, e cila ka rezultuar në humbje të konsiderueshme monetare të viktimës. Nuk është vërtetuar saktësisht se kush i ka nxitur veprat penale në fjalë: pra nëse i pandehuri i parë i ka shfrytëzuar këta dy të tjerët për përfitime të veta apo nëse këta dy të fundit e kanë shfrytëzuar të parin për përfitimet e tyre. Por fakti se këta kanë qenë personat të cilët e kanë mbajtur dobinë pasurore për vete është një rrethanë e rëndësishme rënduese.

Edhe pse nuk kanë qenë persona zyrtarë, kjo rrethanë llogaritet rënduese – përfshirja e tyre me dikë që ka përgjegjësi të larta në sektorin e drejtësisë, edhe pse jo edhe aq rënduese sikur në rastin e të pandehurit të parë, megjithatë shkelja e besimit të publikut në drejtësi është faktor me rëndësi që shkon në dëm të të pandehurve të cilët kanë pasur rolin e tyre në shkeljen në fjalë.

Fakti se ata kanë kryer dy vepra penale po ashtu vlerësohet si rrethanë rënduese.

I pandehuri **R.Z** është njeri afarist i cili pa dyshim se ka pësuar dëme në zhvillimin e aktivitetit të tij. Është i martuar dhe ka dy fëmijë. I pandehuri **X.Z** është gjithashtu i martuar dhe ka tre fëmijë. Këto rrethana personale kanë gjithashtu vlerë lehtësuese, po për ato arsye të cilat janë përmendur më parë edhe për të pandehurin e parë.

Të pandehurit në fjalë nuk kanë qenë të dënuar më parë, prandaj fakti se kanë kryer vepra penale për herë të parë llogaritet në favor të tyre.

Në fund, ata kanë pasur një sjellje të gabueshme gjatë gjykimit dhe atë në mënyrë të vazhdueshme dhe të keqe. Duke vepruar kështu dhe duke mos treguar një sjellje me të cilën do ta tregonin vullnetin e tyre për t'i pranuar pasojat e veprimeve të veta, këta të pandehur kanë provuar se domosdoshmëritë për parandalimin e tyre janë më të fuqishme në rastin e tyre.

Në përgjithësi, Gjykata e Apelit e vëren se ekzistojnë arsye për shqiptim të një dënimi të barasvlershëm me burgim ndaj të tre të pandehurve të parë. Për arsye të ndryshme, pesha e faktorëve lehtësues dhe atyre rëndues nuk dallon nga njëri tjetri. Pasi kemi ulur dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit **N.M**, është e udhës t'i ulim dënimet për pikën e parë edhe ndaj këtyre të pandehurve. Duke i pasur parasysh këta faktorë, Gjykata e Apelit konsideron se sanksionet individuale prej 1 vit burgim për veprën penale të ushtrimit të ndikimit (neni 345.1 i KPRK-së) dhe 3 vjet burgim për veprën penale të shtytjes për keqpërdorim të pozitës zyrtare apo autorizimit (neni 422.1 i KPRK-së), të shqiptuara ndaj të pandehurve në fjalë janë sanksione adekuate dhe proporcionale me shkallën e fajit të tyre dhe me nevojën për parandalim dhe për qortim shoqëror.

Dënimi unik duhet patjetër të ulet. Nuk ka justifikim të bëhet dallimi në mes të këtyre të pandehurve prej të pandehurit të parë, pasi që matja e të gjithë faktorëve të përgjegjësive së tyre është e barasvlershme. Prandaj, në mes të dënimit minimal prej 3 vjetësh dhe atij maksimal prej 4 vjetësh, burgim adekuat është shqiptimi i burgimit prej 3 vjet e 6 muaj burgim.

Në fund, Gjykata e Apelit konstaton se konfiskimi i gjëseneve prej 1 deri në 14 dhe 24, të sekuestruara gjatë bastisjes së shtëpive të të pandehurve **R.Z** dhe **X.Z** nuk mund të mbahet tutje. Kjo çështje edhe më herët është sjellë në vëmendjen e gjykatës. Me vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 24 janar 2013, aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë me të cilin është urdhëruar kthimi i gjëseneve të konfiskuara është anuluar për shkak të nevojës së sigurimit të urdhrorit të mundshëm që të pandehurit të paguajnë shumën e parave që korrespondon me dobinë pasurore, në përputhje me nenin përkatës. Gjykata e Apelit po ashtu ka gjetur se gjësendet e konfiskuara nuk kanë qenë të lidhura me veprat penale në fjalë. Aktgjykimi i ankimuar ka urdhëruar “realizimin” e këtyre gjëseneve por nuk ka urdhëruar konfiskimin e dobive pasurore të të pandehurve. Prandaj, pasi që nuk ka urdhër për pagesë i cili duhet të sigurohet dhe pasi nuk dihet nëse do të parashtrohet ndonjëherë kërkesë pronësore juridike apo jo, gjësendet në fjalë duhet patjetër t’iu kthehen të pandehurve.

M.N

E pandehura në fjalë ka qenë pa dyshim lidhja më e dobët e situatës e cila ka qenë objekt gjykimi. Ajo ka vepruar sipas udhëzimeve të të pandehurit të parë, që do të thotë se ka pasur një lloj respekti apo një lloj varësie ndaj tij, gjë e cila në mënyrë të konsiderueshme e ul shkallën e fajësisë së saj.

Si fakte të tjera lehtësuese, Gjykata e Apelit i gjen mungesën e provave se ajo ka përfutuar ndonjë dobi pasurore, situatën personale të saj, të qenit nënë e tre fëmijëve, faktin se nuk është dënuar më herët si dhe sjelljen e saj pa të meta gjatë gjykimit.

Po ashtu fakti se dënimi i saj do të ketë efekt dëmtues në situatën e saj personale duhet të vlerësohet për shkak se nga perspektiva e rehabilitimit, është me rëndësi që mos të privohet rëndë nga shansi i saj për t’u integruar nga aspekti profesional.

Duke i pasur parasysh rrethanat të cilat u përmendën, Gjykata e Apelit konsideron se dënimi prej 6 muajsh i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është dënim adekuat. Megjithatë, duke e pasur parasysh shkallën më të ulët të fajit dhe qëllimet e rehabilitimit, është proporcionale t'i kushtëzohet dënimi në afat prej 2 vjetësh, në bazë të neneve 41 (1) 1), 42 dhe 44 të KPK-së.

Për të gjitha arsyet e dhëna si më lart, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv.

Kryetari i kolegjit

Manuel Soares, gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Tore Thomassen, gjyqtar i EULEX-it

Anëtarja e kolegjit

Tonka Berishaj, gjyqtare e Gjykatës së Apelit

Procesmbajtësja

Anna Malmstrom, zyrtare ligjore e EULEX-